

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7375 E mërkurë 6 Dhjetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Me 28 nëntor 1944, Shqipëria - nga një pushtim i vjetër, në një pushtim të ri! Data 28 Nëntor 1944 mbahet si dita e Çlirimit të Shqipërisë dhe ...
Vijon në faqet 11-12

Nga SALI BERISHA

Debatimi për datën e Çlirimit, Berisha thirrje shqiptarëve: Më mirë vonë se kurrë!



Opinion

Ditës

Nga ZOJË JAKAJ

Hera e parë prej vitesh që mungon amnistia për të dënuarit e të gjitha veprave penale. Nuk e di i ka shkelur apo jo burgjet shqiptare znj. ministere për të kuptuar ...
Vijon në faqen 12

Amnistia e munguar dhe të drejtat e njeriut



Mbingarkesa dhe mosrespektimi i kontratës së punës

"Tërmet" në QSUT, dorëhiqen 8 mjekë, Vargu: Zv.ministria s'na thirri në takim

Mjeku: Shefi i Urgjencës s'mund të flasë në emrin tonë. QSUT: Puna vijon normalisht. Shehu e Spahia: Ngjarje shumë e rëndë...

Nga VOLTIZA DURO

Ditën e djeshme, 8 mjekë të Urgjencës Qendrore në QSUT kanë njoftuar se do të japin dorëheqjen për shkak të kushteve të rënda të punës. Në shkresën që i kanë dërguar drejtorit të përgjithshëm të kësaj qendre ...
Në faqet 8-9

VENDIMI I QEVERISE/ LISTA E PLOTE ME EMRAT DHE SIPERFAQET NE TE GJITHE VENDIN

"NJE MIJE PRONARE MARRIN KOMPENSIM, 2 MIJE TAPITE"

ALUIZNI: Gati certifikatat e pronësisë për ata që kanë ndërtuar në tokat e të tretëve. Dëmshpërblehen direkt edhe ish-pronarët e truallit"



(Në foto) Ndërtime në proces legalizimi

Në faqet 17-23

VAJZA QE THEU TABUTE



Egla Harxhi: Në treshen tonë do të vijë një fëmijë, nuk ndjehemi xhelozë

Suplement

INTERVISTA/ Miku i ngushtë: Tallavaja për të do zhduket si sobat bullgare

Petrit Ruka: Ju tregoj ditën e fundit të Kujtim Laros

"Si u njoh me Margën në Kukës dhe dashuria e tij për muzikën"

Nga FATMIRA NIKOLLI

Një ditë para se të ikte, vetëm 24 orë përpara se të ndërronte jetë, ia këtë skicë portret për mikun e tij. Petrit Ruka thotë se nuk e di se ç'i shkrepri në kokë Aleksandër Lalos, kur i kërkoi një stilolaps kamarierit të



kafes dhe tha: Petrit, do të të bëj një skicë! E firmosi dhe ia dha. Ruka, e palosi dhe e futi në xhepin e xhakëtës. Sipas Lalos, ky ishte Ruka në atë çast, diku rreth orës 19:30 të datës 19 nëntor 2017. Të nesërmen do të ndaheshin fizikisht njëherë e përgjithmonë ...
Në faqen 10

BATUTAT NE FORUM

Rama takon Junker: Rekomandim për në BE, nëse vijoni reformat

Në faqen 3

KRIMET E RENDA

Trafiku i 2.5 tonëve drogë nga Durrësi, në pranga nënkomisari i Fierit e dy të tjerë

Në faqen 7

DEKLARATA

Kryemadhi në SHBA: Reforma në drejtësi sipas Kushtetutës, integrimi domosdoshmëri

Në faqen 2

USHQIME E VESHJE

Përmbytjet, Shqipëria kërkon ndihma nga NATO, Bullgaria na mbështet e para

Në faqen 6

INTEGRIMI TAKIMET

Presidenti Daul: PPE, mbështetje PD-së si alternativë qeverisëse

Krimi, Basha në Bruksel: Qeveria po pengon integrimin në BE

"Çështja 'Tahiri', shqetësim mbrojtja politike"

Valentina Madani

Nga Brukseli, kreu i opozitës, Lulzim Basha akuzoi qeverinë "Rama" si penguese të integrimit të Shqipërisë drejt BE-së, për shkak të lidhjeve të forta me krimin e organizuar. Kreu i PD-së apeloj se kërcënimi dhe pengesa kryesore mbetet kriminalizimi i politikës dhe ekonomisë së vendit. Nga ana tjetër, z.Basha mori mbështetjen e PPE-së për alternativën qeverisëse. Z.Basha takoi dje në Bruksel presidentin e Partisë Popullore Europiane, Joseph Daul. Pozita e vështirë në të cilën qeveria e ka vënë Shqipërinë dhe integrimin e saj evropian ishte tema kryesore e takimit. Kryetari i opozitës ndau me presidentin e PPE, shqetësimin se mbrojtja politike përmes imunitetit parlamentar të ish-ministrit të Brendshëm, Tahiri, i akuzuar për trafik ndërkombëtar droge, dështimi i policisë për të arrestuar tre ish-drejtuës të lartë të saj për të njëjtën dosje droge, si dhe përpjekja për të emëruar një Prokuror të Përgjithshëm vetëm me votat e PS janë veprime të qeverisë për të penguar drejtësinë dhe që minojnë shanset e vendit për integrim evropian. Me presidentin Daul u bisedua edhe rreth shqetësimit të shumë vendeve anëtare të Bashkimit Evropian në drejtim të hapave që vendi ynë duhet të ndërmarrë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Rezultatet në luftën kundër krimit, drogës dhe korrupsionit konsiderohen si kushte të patjetkueshme për integrim evropian të Shqipërisë. Kreu i PD tha se interesi më i mirë i shqiptarëve është nisja e bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Kërcënimi dhe pengesa kryesore mbetet kriminalizimi i politikës dhe ekonomisë së vendit. Për të avancuar projektin evropian të vendit, opozita ka parashtruar si



Kreu i opozitës, Lulzim Basha me presidentin e Partisë Popullore Europiane, Joseph Daul

PENGESA

Kreu i PD-së, Lulzim Basha gjatë takimit me presidentin e PPE tha se interesi më i mirë i shqiptarëve është nisja e bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Kërcënimi dhe pengesa kryesore mbetet kriminalizimi i politikës dhe ekonomisë së vendit.



Kryeministri Edi Rama, dje në Samitin për Ballkanin Perëndimor, organizuar nga Miqtë e Europës

KREU I PD-SË

Kërcënimi dhe pengesa kryesore mbetet kriminalizimi i politikës dhe ekonomisë së vendit. Për të avancuar projektin evropian, opozita ka parashtruar si zgjidhje politike krijimin e një qeverie antimafia, që do të shkëpusë lidhjet e krimit me politikën, do të përgatisë një reformë të vërtetë zgjedhore.

"Integrimi evropian, domosdoshmëri politike"

Kryemadhi në SHBA: Reforma në drejtësi, sipas Kushtetutës

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, gjatë qëndrimit në Uashington, e ftuar nga "The George Washington University", mori pjesë në një bashkëbisedim me bordin drejtues të këtij universiteti mbi udhëkryqin në të cilin ndodhet ekonomia shqiptare, papunësinë kritike të rinjve në Shqipëri, rëndësinë e cilësisë së arsimit të lartë për përfshirjen dhe integrimin e të rinjve në tregun e punës. Kryemadhi theksoi që në fillim të ligjeratës së saj se këto probleme të thella dhe me zgjidhje pa vizion në Shqipëri kanë ardhur për shkak të përjashtimit të botës universitare dhe akademike nga vendimarrja politike dhe ka ardhur koha që kësaj dukurie shumë negative dhe me pasoja të rënda shumëvjeçare t'i jepet fund. Në ligjeratën e saj, Kryemadhi nënvizoi nevojën e Integrimit më të mirë të të rinjve në tregun e punës nëpërmjet implementimit të strategjive që lidhen me inovacionin dhe informatizimin, ku rind



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, në Uashington, e ftuar nga "The George Washington University"

Negociatat

Kryemadhi shprehu bindjen se procesi i integrimit evropian është një domosdoshmëri politike pa kthim, duke theksuar se hapja sa më parë e negociatave për anëtarësim do të ndihmonte jo vetëm Shqipërinë, por do të siguronte edhe një balancë më të qëndrueshme për kontrollin më të mirë ndaj qeverisjes dhe konsolidimit të shtetit të drejtës.

ia shqiptare ka demonstruar prirje e aftësi të veçanta dhe ku tregu i punës i së ardhmes është i orientuar fort në këto drejtime. Ajo shprehu bindjen se procesi i Integrimit Evropian është një domosdoshmëri politike pa kthim, duke theksuar se hapja sa më parë e negociatave për anëtarësim do të ndihmonte jo vetëm Shqipërinë, por do të siguronte edhe një balancë më të qëndrueshme dhe do ta çojë vendin me sukses drejt një qeverie legjitime përmes zgjedhjeve të lira e të ndershme. Kryetari Basha e falënderoi presiden

për kontrollin më të mirë ndaj qeverisjes dhe konsolidimit të shtetit të drejtës. Për një zhvillim të shpejtë e të qëndrueshëm të vendit, Kryemadhi vendosi theksin edhe te zbatimi i shpejtë i reformës në drejtësi, por gjithmonë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, si një premisë shumë e rëndësishme jo vetëm për të rritur besimin e shqiptarëve te drejtësia, por edhe për të rritur njëherazi edhe sigurinë juridike të investimeve dhe bizneseve në Shqipëri. Anëtarët e bordit të cilët janë ekselencia shkencore e këtij universiteti, nga më të njohurit në botë, shprehën gatishmërinë e tyre për të mbështetur nismat e reja inovative, jo vetëm në fushën e rinisë, por dhe për çështje madhore, siç janë investimet e huaja direkte dhe trajtimet e biznesit të vogël.

Presidenti Daul i garantoi Lulzim Bashës mbështetjen të plotë të PPE-së për Partinë Demokratike si alternativë qeverisëse.



Patozi, Bashës: Çoje PD-në për 'check-up' te Rama

Ish-deputeti i Partisë Demokratike, Astrit Patozi thumboi sërisht dje kryedemokrat Lulzim Basha. Përmes një postimi në faqen e tij të "Facebook"-ut, Patozi i bëri 'thirrje' Bashës që ta çojë PD-në për check-up tek kryeministri Edi Rama. "Çoje PD-në tek 'check up'-i i Ramës. I dashur Lulzim, ka vetëm një mënyrë për të dalë me sukses kjo analiza që ke shpallur se po bëhet në Partinë Demokratike, pas fitoreve të njëpasnjëshme në zgjedhje. Jepja më mirë ta bëjë Vilma Nushi, e cila ka marrë koncesionin e 'check up-it'. E para, ta bën shpejt; e dyta, ta bën falas; e treta, ta nxjerr si ta duash vetë, por më kryesorja është se ta njeh edhe qeveria", shkruan z.Patozi në "Facebook".



Kryeministri takon presidentin e KE: Pa BE s'mund t'i kryejmë reformat

Juncker: Hapim negociatat, nëse vijon progresi për 6 muaj

Batutat në forum, Rama: Duam të martohemi me këtë union

Darina Tanushi

Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, u shpreh dje i impresionuar nga progresi që ka bërë Shqipëria në fusha të ndryshme kryesive sa i përket reformës në drejtësi. Juncker i tha këto përshtypje, pas takimit me kryeministrin shqiptar, Edi Rama, në Bruksel. Në deklaratën pas këtij takimi, presidenti i KE-së u shpreh: "Ne lavdërojmë përpjekjet e kryeministrit për të luftuar korrupsionin në mënyrën më të mirë të mundshme dhe është bërë një progres domethënës në këtë drejtim. Si përfundim, për ato që po ndodhin në vend, që u shtohen atyre që janë bërë, ne jemi shumë të lumtur me çfarë po ndodh në Shqipëri. Nëse bëhet progres i mëtijshëm gjatë gjashtë muajve në vijim dhe mendojmë që do të bëhet progres dhe më tej, synoj që t'i propozoj Këshillit të Ministrave të vendeve anëtare hapjen e negociatave, por kjo do të varet nga progresi reformave në muajt që vijnë. Jam besimplotë se kjo do të ndodhë në mënyrën më të mirë të mundshme". Nga ana e tij, kryeministri Rama u shpreh: "Është një kënaqësi e madhe t'ju dëgjoj dhe të kuptoj ndjesinë e gatishmërisë që kemi për të na mbështetur në këtë proces, që siç ju thaatë, nuk përfundon kurrë, por duhet të konfirmohet javë pas javë e muaj pas muaji, duke e ditur që gjashtë muajt në vijim do të jenë thelbësorë për të pasur mundësinë që të hyjmë në një fazë të re, e cila do të jetë e vështirë, por absolutisht e nevojshme për fillimin e negociatave për anëtarësim". "Për mua është krenari që erdha sot në Bruksel, me rezultate të prekshme, të konfirmuara nga të gjithë ju. Ajo çfarë mund të them në fund është se largohem nga Brukseli me bindjen që edhe më shumë rezultate të prekshme duhet të vijojnë", tha Rama. Më tej presidenti i KE-së, Juncker shtoi se do të vizitonte Shqipërinë vitin që vjen. Ajo që ra në sy ishte fakti se Juncker, i pyetur nga gazetarja shqiptare për deklaratën e tij për anëtarësimin më parë të Malit të Zi dhe Serbisë, i sugjeroi asaj të mos citojë gazetaret dhe gazetën, në këtë pikë edhe Rama ishte dakord me Juncker. Më pas, kryeminis-



Presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker me kryeministrin Edi Rama, në Bruksel

tona. Nuk mendoj se pa BE-në, pa integrimin në BE, do të ishim në gjendje që të kishim reformat që po kryejmë, nuk do të ishim në gjendje që të kërkonim një sistem real, të fortë, të pavarur dhe efikas drejtësi. Pra, pa të nuk do të ishim në gjendje që të zhvillojmë, apo të kishim një proces kaq tërësor të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistemin e drejtësisë. Dhe kjo ndodh vetëm sepse ne duam të jemi pjesë e kësaj familjeje", theksoi Rama. "Duke qenë se kjo është një mundësi e hapur, Ballkani në përgjithësi dhe Shqipëria në veçanti do të bëjnë përparim të konsiderueshëm, por në qoftë se kjo zbehet, apo shndërrohet në një iluzion, atëherë gjërat mund të marrin drejtimin e gabuar", u shpreh Rama. Kryeministri tha se rajoni ka një shans "mjaft unik për t'u divorcuar përfundimisht me të shkuarën dhe më në fund të marrohet me këtë union të shkëlqyer, që thotë tërë kohë, "dua të marrohem, po nuk jemi gati të flasim për këtë". "Dhe unë nuk e di se si mund të ndodhë kjo. Po, në mesjetë kishim martesë pa folur, por ky nuk është rasti, ndaj kjo është arsyeja përse ne në Ballkan kemi nevojë e duam të flasim. Ju i qani bisedime për anëtarësim, që do thotë, bisedime për martesë. Në qoftë se do të ndodhë, do të ndodhë", u shpreh Rama.

ANTONIO TAJANI
"Në pranverë do të kem një vizitë zyrtare në Shqipëri, i shoqëruar me një delegacion sipërmarrësish evropianë, në mënyrë që të sigurohemi që ky raport i privilegjuar me një vend, i cili duhet të shndërrohet në vitet e ardhshme në një anëtar me të drejta të plota të BE, të mund të shndërrohet edhe në një raport konkret për të krijuar vende të reja pune, për të nxitur zhvillimin dhe punësimin", tha presidenti i PE-së.

FEDERICA MOGHERINI
"Nën lidhësinë e tij, Shqipëria ka bërë një punë të jashtëzakonshme, veçanërisht në reformën e drejtësisë, luftën kundër drogës dhe korrupsionit, një punë që ne e mbështesim e që duhet të vazhdojë përpara dhe kjo është një punë që mund të hapë rrugën drejt hapave të mëtijshëm të procesit të integritimit në BE", tha dje Mogherini në takimin me Ramën.

tri Rama mori pjesë me diskutimin e tij në Samitin për Ballkanin Perëndimor, organizuar nga Miqtë e Europës. "Unë nuk mendoj se do ta teproja po të thosha se pa BE-në aty nuk do të kishim kurrë atë çfarë kemi në Ballkan aktualisht sa i takon

pajtimin, paqes dhe procesit të bashkëpunimit. Kjo nënkupton se për ne dhe Ballkanin, BE-ja është mjaft e rëndësishme si forcë shtytëse drejt së ardhmes dhe se integrimi në BE është një instrument unik i organizimit të shteteve e shoqërive

ERJON BRAÇE

Deputeti i PS-së, Erjon Braçe, i kërkoi Bashës të kthehet në Shqipëri dhe të mos flasë keq për vendin në Bruksel. "Ore Lul, ore Lul, po kë ke takuar në Bruksel që i ke dalluar 'stepjen' përkundër Shqipërisë sonë-tonës, tëndes ende jo? Ktheu Lul, kthehu. Hajde se kemi lenë edhe tabelën e shumëzimit pa përsëritur!".



Drejtori i Zgjerimit në KE, Danielson: Koha të ecim më tej me integrimin e Shqipërisë

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, mori pjesë në Bruksel në konferencën "Pritshmëri të larta për vitin 2018. Hapi pasardhës i Shqipërisë në procesin e integritimit evropian". Gjatë diskutimit të tij, Bushati theksoi se pritshmëritë e qeverisë dhe shoqërisë shqiptare që bazohen në punën e bërë dhe progresin e arritur e bëjnë vitin 2018 të veçantë dhe përcaktues për hapat e mëtijshëm në konkretizimin e procesit evropian të Shqipërisë. Duke argumentuar mbi rëndësinë që ka marrja e vendimit për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit për Shqipërinë, Bushati nënvizoi gatishmërinë e qeverisë për t'u angazhuar në këtë ushtrim transformues për vendin dhe shoqërinë. "Arritjet tona përbëjnë tashmë një bazë solide për përparim thelbësor e cilësor në procesin e integritimit në një sërë fushash parësore, në mënyrë të veçantë për kapitujt 23 dhe 24", theksoi Bushati. Drejtori i Përgjithshëm për Zgjerim në Komisionin Evropian, Christian Danielson, përgëzoi qeverinë shqiptare për ecurinë e reformave, në mënyrë të veçantë asaj në drejtësi dhe theksoi rëndësinë e ruajtjes së ritmit të tanishëm. "Dinamika e zhvillimeve në Shqipëri - theksoi ai - po krijon një besim në rritje në Bashkimin Evropian se ka ardhur koha për të ecur më tej në procesin e integritimit evropian". Ai theksoi se në shkurt 2018 komisioni do të paraqesë strategjinë e zgjerimit dhe në muajin prill do të prezantojë raportin mbi Shqipërinë, ku do të paraqiten propozimet e komisionit, mbështetur në analizën e rezultateve të arritura në plotësimin e pesë përparësive kyç. Raportueset për Shqipërinë, eurodeputeti Eduard Kukan, theksoi se ai ishte dëshmitar i ndryshimeve të ndodhura në Shqipëri, të cilat sipas tij kanë krijuar besim tek të dy grupimet e mëdha politike në Parlamentin Evropian për ta ftuar sa më parë Shqipërinë në tavolinën e bisedimeve për anëtarësim.

Kryetari i Kuvendit shoqërohet nga Balla, Kodheli e Angjeli

Gramoz Ruçi nis për në SHBA, me ftesë të Kongresit amerikan

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi u nis dje për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në krye të një delegacioni të Parlamentit shqiptar. Me ftesë të Kongresmenit Robert Pittinger, zëvendës-kryetar i Nënkomisionit për Terrorizmin dhe Financimin e Paligjshëm në Kongresin Amerikan, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, do të marrë pjesë në Forumin e 10-të Parlamentar për Intelligjencën dhe Sigurinë në Uashington në datën 7 dhjetor 2017. Gjatë kësaj



vizite, kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi shoqërohet nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Social-

iste, z. Taulant Balla; kryetarja e Komisionit për Politikën e Jashtme, znj. Mimi Kodheli dhe nga deputeti Asnastas Angjeli si dhe kreu i PR-së, Fatmir Mediu. Forumi i 10-të Parlamentar për Sigurinë dhe Intelligjencën ka 119 pjesëmarrës nga 45 vende për të diskutuar mbi financimin e terrorizmit, sigurinë kibernetike dhe bashkëpunimin në fushën e intelligjencës. Vizitat e kreu të Kuvendit në SHBA shuan të gjithë zërat për refuzim të tij nga ana e politikës amerikane.

KRYEPROKURORI DEBATI

Zgjedhja me 36 vota, PD-ja: Me 3/5-at, PS-ja synon të mbulojë dosjet e bujshme

Beteja për kryeprokurorin e ri, nesër mbaron mandati i Lallës

Manja: Për mandatin, përgjigjen e jep Kuvendi

Valentina Madani

Mazhoranca shprehet e vendosur për të zgjidhur ngërçin ligjor të krijuar në vend në lidhje me kryeprokurorin e ri, duke theksuar se Adriatik Lalla largohet nga detyra në datën 7 dhjetor 2017. Por, opozita e kundërshton një gjë të tillë, duke e cilësuar si shkelje të Kushtetutës. Në një deklaratë për mediat, deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi deklaroi dje se pas skenarit të PS për zgjedhjen e kryeprokurorit me 36 vota fshihen interesa dhe mbulim dosjesh të bujshme. Sipas Bylykbashit, Partia Socialiste po shfrytëzon boshllëkun kushtetues për të kapur kryeprokurorin e ri. Ai argumentoi se duhet të krijohet njëherë Këshilli i Lartë i Prokurorisë, që kryeprokurori i ri të mos i shmanget as vettingut. Sa për votimin në Parlament, Bylykbashi theksoi se ai duhet të zgjidhet me 3/5 e votave. "Rregullat janë të qarta, Kushtetuta e përcakton që KLP si organ që deklaron fundin e mandatit të kryeprokurorit. Fakti që ka boshllëk kushtetues është një problem që nuk mund të zgjidhet me deklaratat", - tha ai duke lëshuar akuza ndaj PS se ka si synim të kapë kryeprokurorin. "Ligji përcakton se merr vendim Kuvendi me 3/5 dhe kjo është një çështje tjetër. Janë të gjitha përpjekjet e shumicës që kryeprokurorin kërkon ta zgjedhë me 36 vota, përfshirë edhe votën e Tahirit, që të mbyllin të gjitha dosjet dhe çështjet e skandalit të karakterit korruptiv, por edhe kriminal, si në rastin e Tahirit", - deklaroi z.Bylykbashi. Por, deputeti i PS-së, Ulsi Manja, bëri dje të qartë se debati për mandatin e kreu të ri të organit të akuzës do të gjejë zgjidhje



Kryeprokurori Adriatik Lalla

Dorëheqja e Muçës/ KQZ sot i jep mandatin deputetes së re të PDIU

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve diskuton sot mes të tjerash edhe vendimin për zëvendësimin e mandatit të deputetit të dorëhequr të PDIU-së, Bujar Muça. Pas dorëzimit të mandatit nga Muça, KQZ ia ka dorëzuar Kuvendit. Pas miratimit të Kuvendit, i kthehet KQZ-së, e cila shpall vakancën dhe merr personin pasardhës në listë, që shkon në Kuvend dhe bën betimin. Elena Xhina do të zëvendësojë Bujar Muçën. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ditën e mërkurë, më datë 06.12.2017, ora 12:00, zhvilloi mbledhjen me këtë rend dite: Shqyrtimi i projektit vendimor: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumemënore të Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet në Qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Shqyrtimi i projektit aktit - Për verifikimin e deklaratimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit, nga listat shumemënore për Këshillin Bashkiak, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushrojnë funksione publike", thuhet në njoftimin e KQZ-së.



OERD BYLYKBASHI

Z.Bylykbashi argumentoi se duhet të krijohet njëherë Këshilli i Lartë i Prokurorisë, që kryeprokurori i ri të mos i shmanget as vettingut. Sa për votimin në Parlament, Bylykbashi theksoi se ai duhet të zgjidhet me 3/5 e votave.



Gjatë një seance parlamentare

ULSI MANJA

"Kësaj çështjeje i ka dhënë përgjigje edhe Kushtetuta, edhe neni 109 2 i ligjit për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë. Që do të thotë mandati i prokurorit mbaron në datën 7 dhjetor 2017".

Ngërçi, si zgjidhet kryeprokurori i ri

Ngërçi që krijohet për zgjedhjen e kryeprokurorit ka të bëjë me mosngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i cili sipas Kushtetutës, ka si kompetencë deklarimin e mbarimit të mandatit të kryeprokurorit, por njëherazi i propozon Kuvendit edhe 3 kandidataturat për këtë pozicion. OPDATE dhe EURALIUS përmes një dokumenti të publikuar pak kohë më parë nga "BalkanWeb" u janë referuar dispozitave tranzitore për zgjedhjen e kryeprokurorit, duke sugjeruar zgjedhjen e një prokurori të përkohshëm deri në ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. PS duket e vendosur të shkojë drejt kësaj linje, ndërsa opozita e ka kundërshtuar. Por çfarë parashikon neni 148 i Kushtetutës? Proku-



rori i Përgjithshëm zgjidhet me tre të pestat e anëtarëve të Kuvendit, mes tre kandidatëve të propozuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, për një mandat 7-vjeçar dhe pa të drejtë riemërimi. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në një thirrje publike dhe procedurë transparente, përzgjedh dhe rendit tre kandidatët më të kualifikuar dhe ia përcjell Kuvendit, sipas ligjit. Prokurori i Përgjithshëm zgjid-

het nga radhët e juristëve të spikatur, me jo më pak se 15 vjet përvojë pune, me integritet të lartë moral dhe profesional, që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës ose kanë një gradë shkencore në drejtësi. Kandidati nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Nëse Kuvendi nuk zgjedh Prokurorin e Përgjithshëm brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimeve, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpallet i emëruar. Pas përfundimit të mandatit dhe me kërkesë të tij, Prokurori i Përgjithshëm emërohet në detyrën e mëparshme ose gjyqtar në Gjykatën e Apelit.

bazuar në Kushtetutën e Republikës, duke nënkuptuar kështu se Kuvendi do të procedojë me zgjedhjen e një prokurori të ri të përkohshëm. "Kësaj çështjeje i ka dhënë përgjigje edhe Kushtetuta, edhe neni 109 2 i ligjit për organizimin dhe funk-

sionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë. Që do të thotë mandati i Prokurorit mbaron në datën 7 dhjetor 2017. Kuvendi i Shqipërisë do të ketë një përgjigje për këtë situatë të krijuar", u shpreh z.Manja. Çështja e Prokurorit të ri të

Përgjithshëm është kthyer në debat politik në vend, për shkak se nuk është ngritur ende Këshilli i Lartë i Prokurorisë, që duhet të propozonte kandidatit pasues të Adriatik Lallës. Në kushtet e mosngritjes së KLP-së, Kuvendi i Shqipërisë duket se është

të i detyruar nga dispozitat ligjore në fuqi të zgjedhë një Prokuror të Përgjithshëm të përkohshëm për drejtimin e organit të akuzës. OPDATE dhe EURALIUS përmes një dokumenti të publikuar pak kohë më parë nga "BalkanWeb" u janë referuar dispozi-

tave tranzitore për zgjedhjen e kryeprokurorit, duke sugjeruar zgjedhjen e një prokurori të përkohshëm deri në ngritjen e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. PS duket e vendosur të shkojë drejt kësaj linje, ndërsa opozita e ka kundërshtuar.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne datë 06.12.2017 në orën 16:00 në zyrën e përbaruesit gjyqësor privat Irista Tereziu PF Me adresë ne : Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, njesia Tregtare nr. 10 Tirane, zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë së palaujtshme të llojit "Njesi " me sipërfaqe totale 87.2 m2 ,numër pasurie,15/231 -N1, vol.2014 -2016, ne zonen kadastrale 8551 me adresë Kavaje. Cmimi ne ankand te dYTE është ne vleren 5,830,687.52 (pese milion e teqind e tridhete mije e gjashteqind e tetedhete e shtate oke pesedhete e dy Lek)

MINISTRIA E DREJTËSISE DREJTORIA E PËRGJITHSHMË E PËRMBARIMIT ZYRA PËRMBARIMORE TIRANE

Zyra e Përbarimit Tirane me përbarues gjyqësor Albert Fejzo, ne baze te vendimit nr. 10484, date 30.11.2017, shpall shitjen ne ankand te pasurise apartamentin te banimit me sipërfaqe 57 m2 te ndodhur ne Rrugën: "Irfan Tomini", pallati 10/2/60 ne Zonen kadastrale 8260 te regjistruar Zyra Vendore Regjistrimit Pasurise Palaujtshme Tirane me nr pasurie nr 254-4-40, volumi 6, faqe 82 Tirane, ne vleren duke filluar nga 2,800,000 (dy milion e teqind mije) Lek.

Ankandi zhvillohet me ambientet e Zyres te Përbarimit Tirane, ne adresen : Sheshi Mustafa Ataturk , Kryeqezimi " 21 Dhjetori", Tirane ditën e Premte , me date 15.12.2017, ora 16.00.

Përbaruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje ne ankand pasurine :

"Toke Are truall nr pasurie 222/11, vol 4, faqe 83 ne Zonen Kadastrale 3652 ndodhur ne fshatin Trush , Njesia Administrative Berishte , bashkia Shkoder

Cmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkujtuar, është në vlerën 736.000 (shiqteqind e tridhete e gjashtëmije) lekë

Shitja e pasurisë do të behet (zhvillohet) me date 07.12.2017 ora 16.16 ne Zyren e përbaruesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Forballe Gjykatës së rethit Gjyqësor Shkoder. Përsoset e interesuar duhet te drejtohen përpara fillimit te ankandit 10% te vleres si garanci ne Bankën BKT dega Shkoder me nr logjare 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 13839100.



105-vjetori i krijimit, Forcat e Armatosura ekspozojnë automjetet dhe armatimet

Meta: Kontribuues për paqen Xhaçka: Kemi ushtri gjitharmësh

"U krijua në kohën e pavarësisë, u konsolidua në LANÇ"

Forcat e Armatosura të Shqipërisë festuan dje 105-vjetorin e krijimit të tyre. Në prani edhe të Kreut të Shtetit, Ilir Meta në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të FA dhe ministres së Mbrojtjes u ekspozuan në sheshin "Nënë Tereza" mjete të transportit si dhe armatime që përdoren nga FA në rast të ndryshme. Me këtë rast u vlerësua me medalje nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm e Baza Ajrore e Farkës, e cila shënoi 50-vjetorin e krijimit të saj. Presidenti Meta dhe të pranishmit u takuan me forcat ushtarake shqiptare, të cilat do të nisen me mision në Afganistan dhe Letoni, si dhe vizituan ekspozitën dhe pajisjet ushtarake. "Kjo është një datë historike dhe lavdie për Forcat tona të Armatosura, ashtu sikurse është një gur i fortë themeli në historinë tonë të shtetformimit", u shpreh Meta në fjalën e tij. "Prej disa vitesh ne jemi anëtarë të NATO-s. Në udhëtimin drejt anëtarësimit tonë në Aleancë, ia dolëm ta transformojmë Shqipërinë nga një vend konsumues, në vend kontribuues për paqen dhe sigurinë, veçanërisht në rajon, por jo vetëm. Kjo arritje na bën krenarë me vlerë mbarëkombëtare, na bën krenarë e njëkohësisht të përgjegjshëm për sfiat që kemi përpara", u shpreh Meta. "Forcat tona të Armatosura treguan edhe një herë, gjatë situatës së fundit të përmblyetje në vend, se roli i tyre pranë dhe në shërbim të komuniteteve e qytetarëve, duke garantuar jetën e tyre dhe pronën private e publike, është jo vetëm i pazëvendësueshëm por që kërkon respekt, konsideratë, mirënjohje të veçantë dhe kujdes në rritje", u shpreh më tej Meta. Presidenti shprehu edhe mbështetjen e tij për FA. "Shpreh besimin se përkushtimi dhe sakrificat e tyre do të vlerësohen dhe do të shpërbehen siç e meritojnë", u shpreh Meta. "Duke shprehur kënaqësinë për rritjen e buxhetit për vitin 2018, përkushtimin dhe vetëmohimin e treguar nga Forcat e Armatosura në menaxhimin e emergjencave civile, dëshiroj t'ju konfirmoj se dëshiroj e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, modernizimi dhe rritja e kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura, përmblusja e detyrimeve me kuadër të NATO-s, do të kenë gjithmonë mbështetjen time të fuqishme", garantoj Meta. Nga ana e saj, ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka tha se, "historia e Forcave tona të Armatosura dëshmon më së miri vetë rrugëtimin e shtetit shqiptar ndër vite".



Komandanti i Përgjithshëm i FA Ilir Meta dhe ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, dje në 105 vjetorin e ushtrisë

OLTA XHAÇKA
"Në kohë lufte dhe paqeje, pavarësisht zigzageve të politikës, ju kemi treguar kurajë, nder dhe përkushtim maksimal ndaj detyrës. Sot që flasin, Forcat tona të Armatosura vazhdojnë ditë-natë t'u gjenden pranë mijëra familjeve shqiptare, që përjetojnë përmblytjet e këtyre ditëve dhe pasojat e tyre, kudo që kjo u kërkohet, në fshat dhe në qytet", tha dje Xhaçka.

"Ushtria shqiptare u krijua në kohën e pavarësisë, fitoi fizionomi në kohën e mbretërisë, sikurse u konsolidua si ushtri e të gjithë popullit në zjarrin e luftës nacionalçlirimtare kundër pushtuesit nazi-fashist. Pas lufte e në vijim, ajo tanimë ka krijuar përvojën e saj si ushtri gjitharmësh, me këmbësori, forca të motorizuara, tokësore, ajrore, detare, trupa komando, komunitet inteligjencë, mbrojtje civile, e profilizuar sipas standardeve më të larta të kohës. Kjo nuk ka ndodhur në një ditë, por është trashëguar si kontribut i shumë brezave ndër vite", tha Xhaçka. Sipas saj, "sot, FA shqiptare janë të angazhuara fuqimisht për shtrirjen e tyre lokale, rajonale dhe globale në mbështetje të sigurisë dhe paqes".

CMIMI

Presidenti Meta mori dje pjesë në ceremoninë e dhënies së çmimit 'Honoris Causa' për ministrin e Jashtëm të Turqisë, Mevlut Cavusoglu të zhvilluar në Tiranë. Në ceremoninë e rastit, Meta tha se marrëdhëniet e vendit tonë me Turqinë janë të një rëndësie strategjike, ku nënvizoi bashkëpunimin ekonomik, tregtar apo edhe ato në fushën e sigurisë.



"Shqipëria është kategorizuar si vend i sigurt"

Ambasada gjermane: Asnjë ndihmë financiare për azilkërkuesit që kthehen

Ambasada gjermane në Shqipëri sqaroi dje, se ata shqiptarë që u është refuzuar kërkesa për azil nuk mund të marrin asnjë mbështetje financiare nga Gjermania, duke nisur nga data 1 dhjetor. Nisur nga shkrimet e disa mediave, ambasada hodhi poshtë këto njoftime. "Ndryshe nga ç'raportojnë mediat shqiptare, azilkërkuesit me shtetësi shqiptare në Gjermani, të cilëve u është refuzuar kërkesa për azil, duke nisur nga data 1 dhjetor 2017 nuk mund të marrin në konsideratë asnjë mbështetje të mëtejshme financiare apo asistencë financiare për kthim", thuhet në njoftim. "Gjermania e ka kategorizuar Shqipërinë si vend të sigurt të origjinës: kërkesat për azil nga shtetasit/et shqiptarë/e - sikurse edhe nga vende të tjera të Ballkanit Perëndimor - përpunohen me procedura të përshpejtuara dhe refuzohen praktikisht në çdo rast", theksohet në deklaratën e ambasadës. Sipas saj, "azilkërkuesit e refuzuar duhet të kthehen në Shqipëri dhe mund të dënohen me ndalim hyrjeje në të gjithë hapësirën e vendeve Schengen për një periudhë, që mund të zgjasë deri në pesë vjet, nëse ata nuk pranojnë të largohen me dëshirën e tyre, por kthehen forcërisht në Shqipëri".

PERMBARUESI GJYQESOR PRIVAT ERMIR GODAJ

Permbaruesi gjyqësor privat Ermir Godaj zhvillon ankandin e pare për shlyerjen e pasurisë se paluajtshme "Trazili me sipërfaqe 206 m², nga të cilat 206 m² Ndërtesa, me Nr. Pasurisë 554/3, Vol.5, Fq.163, Z.K.3070, e ndodhur në Pukë", e lëne kotalateral për garantimin e kredisë, për shlyerjen e detyrimit në favor të kreditorit ProCredit Bank Sh. a., për shumën 1'822'310.51 (një milion e tetëqind e njëzetë e dy mijë e treqind e dhjetë pike pesëdhjetë e një) Lekë.
Çmimi fillues me të cilin fillon ankandin është në shumën 1'354'656 (një milion e treqind e pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) Lekë.
Ankandit zhvillohet në datë 18.12.2017, ora 16.00 në zyrën e permbaruesit gjyqësor privat Ermir Godaj, Rruga "Abdi Topiani", qendra Torre Drit, kl.2, nr.33, Tiranë, dhe për informacion mund të kontaktoni nr.0682099471, 0684054605, email ermirgodaj@zyrapermbarimit.com.



Presidenti dekoron ish-kreun e SHISH, Ajazi, liron Demin nga NATO

Presidenti i Republikës, Ilir Meta i akordoi dje ish-kreut të SHISH-it, Visho Ajazi Lika "Dekoratën e Artë të Shqiponjës" me motivacionin: "Për kontributin e tij të veçantë në fushën e sigurisë kombëtare, luftës kundër terrorizmit dhe në veçanti, në luftën kundër kimit të organizuar e trafikut të drogës". Ndërkohë, pritet që presidenti të dekretojë edhe emërimin e Ajazit ambasador në NATO. Burimet nga Presidencia thanë dje: "Presidenti beson se Ajazi do ta realizojë me shumë sukses detyrën e tij në NATO" dhe se ky dekretim do të bëhet pas paraqitjes së tij në Komisionin e Jashtëm. Ndërkohë dje, Presidenti Ilir Meta ka dekretuar lirimin e Leonard Demit nga detyra e ambasadorit të Shqipërisë në NATO.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: RFP - "Mystery shopper: Assessment of performance in central government service delivery"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP Procurement Notices 42992 - RFP - Mystery shopper: Assessment of performance in central government service delivery**

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than December 18, 2017, 15.00 pm.

Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org
Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

PERMBYTJET NDIHMAT

EC: Fillon dezinfektimi i banesave, qendrave shëndetësore, shkollave në Gjirokastrë, Vlorë, Berat etj.

Shqipëria NATO-s: Duam ndihma dhe ushqime

Përmbytjet, Bullgaria ofron e para 8 tonë me ndihma

Ina Allkanjari

Me largimin e ujit nga pjesa më e madhe e zonave që u përmbytën, Shqipëria i është drejtuar NATO-s duke kërkuar ndihmë. "Reshjet e dendura të shiut gjatë ditëve të fundit, kanë shkaktuar përmbytje në pjesën qendrore dhe jugore të vendit. Këto janë reshjet më të forta që kanë rënë ndonjëherë në Shqipëri. Reagimi i institucioneve ka qenë jetik në parandalimin e humbjes së jetës së njerëzve. Nga ana tjetër, bazuar në vlerësimet fillestare, dëmi material ka qenë i madh", thuhet në njoftimin e NATO-s. Në kërkesën që Shtabi i Përgjithshëm i ka drejtuar NATO-s, thuhet se janë përmbytur më shumë se 15 mijë hektarë. Dëmet e shkaktuara janë të tilla: 4715 godina, 41 biznese, 127 akse rrugore, 177 shkolla, 78 ura, 30 stacione ujësjellësi, 11 diga, 26 stacione elektrike, 29 rita dhe një stacioni pompimi uji. Shqipëria kërkon nga NATO me urgjencë këto gjëra: ura portabel (78 copë), 45 metra të gjata, me kapacitet 20 tonë minimumi. Po ashtu kërkohen varka për ujëra të cekët, pajisje për zhytje, gjeneratorë, fuoristrada, pajisje të ndihmës së parë, batanije, tenda, ngrohëse, kostume antiujë, ushqim i konservuar, ushqim fëmijësh, pelena, ushqim për kafshët, etj. Ndërkaq Bullgaria është shprehur e gatshme të dërgojë 8 ton ndihma me ushqime dhe veshje në vendin tonë.

BULLGARIA

Përmbytjet e ditëve të fundit në vendin tonë shkaktuan dëme të konsiderueshme materiale. Pas kërkesës nga Shqipëria drejtuar NATO-s, Bullgaria ka vënë në dispozicion të të prekurve nga përmbytjet ndihma financiare, ushqimore dhe veshmbathje. Sipas kryeministrit bullgar Bojko Borisov, ndihma po përgatitet për Shqipërinë, që është edhe vendi më i dëmtuar pas reshjeve intensive të shiut në Gadishullin e Ballkanit. Sipas agjencisë bullgare të lajmeve "Novinite.com", ndihma është afërsisht 70 000 BGN. Kjo e fundit është siguruar nga rezervat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit,



4715

GODINA

Dëmet e shkaktuara janë 4715 godina, 41 biznese, 127 akse rrugore, 177 shkolla, 78 ura, 30 stacione ujësjellësi, 11 diga, 26 stacione elektrike, 29 rita dhe një stacioni pompimi uji. Në kërkesën që Shtabi i Përgjithshëm i ka drejtuar NATO-s, thuhet se janë përmbytur më shumë se 15 mijë hektarë.

Zyrtari i MB: Me menaxhimin e sivjetshëm s'ka krahasim

Bekim Murati: Në përmbytjet e 2010-ës helikopterët u përdorën si taksi për politikanët

TIRANË- Drejtori i Koordinimit të Prefekturave në Ministrinë e Brendshme, Bekim Murati bën publik bilancin e dëmeve dhe angazhimin e shtetit për përbalimin e tyre. I ftuar në emisionin "Debate në Channel One", Murati deklaroi se menaxhimi i këtyre përmbytjeve nuk mund të krahasohet me menaxhimet e viteve 2010, 2011, 2013. Madje përpara se të jepte shifrat e përmbytjeve në datat 2, 3 dhe 4 dhjetor, ai bëri një akuzë të fortë për përdoruesit e 7 viteve më parë. "Gjatë menaxhimit të përmbytjeve në vitin 2010, helikopterët u përdorin si taksi për politikanët", tha Murati. Sipas tij, shifrat e shpenzimit të karburantit për helikopterë



Drejtori i Koordinimit të Prefekturave në Ministrinë e Brendshme, Bekim Murati

janë tmerrësisht të larta. Më pas Bekim Murati dha shifrat më të rëndësishme për datat 2, 3, 4 dhjetor, dhe punën që kanë bërë instancat e shtetit. Sipas Muratit dëmet e llogaritura janë 3620 shtëpi të dëmtuara, 25.412 hektarë tokë të përmbytur, 77 shkolla, 5 stacione ujësjellësi, 14 argjinatura, 12 qendra shëndetësore dhe 840 bagëti.

SITUATA NË VEND

Pas përmbytjeve të rënda në Shqipëri, operacionet për të përbaluar situatën e vështirë vazhdojnë kryesisht në jug të vendit. Sipërfaqja nën ujë është reduktuar në rreth 4000 ha tokë nga mbi 1000 ha tokë që u përmbytën. Pas tërheqjes së ujerave, struktu-

DEMET

Dëmet e llogaritura janë: 3620 shtëpi të dëmtuara, 25.412 hektarë tokë të përmbytura, 77 shkolla, 5 stacione ujësjellësi, 14 argjinatura, 12 qendra shëndetësore dhe 840 bagëti.

qendra shëndetësore dhe 840 bagëti. Në operacion morën pjesë gjithsej 6866 forca prej të cilave 5464 forca policore dhe 1402 forca të ushtrisë. Ndërkohë si pjesë e të gjithë këtyre operacioneve ishin 1080 mjete lëvizëse, nga të cilat 281 mjete të ushtrisë dhe 799 mjete të policisë.

rat shtetërore kanë filluar dezinfektimin e banesave, qendrave shëndetësore, shkollave, baxhove, thertoreve dhe mini-marketeve, në bashkëpunim me Gjirokastrë, Vlorë, Berat, Urë Vajgurore dhe Krujë. Në Tiranë dhe në Fier vazhdojnë të jenë të akomoduar në qendrat rezidenciale sociale 70 qytetarë të evakuuar.



Përmbytjet në vend, Ministria e Mbrojtjes ngre qendrën e pritjes, ku duhet të drejtoheni

Në kuadër të rritjes së eficientësisë dhe prezencës në kohën dhe vendin e duhur të autoriteteve të përballimit dhe emergjencave civile, Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë ka ngritur Qendrën e Pritjes dhe të Administrimit të Ndihmave. Kjo qendër do t'u vijë në ndihmë të gjithë të interesuarave, si: Organizata Ndërkombëtare, Shoqata joqeveritare, grupime vullnetare etj., të cilët duan të japin kontributin e tyre për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e ditëve të fundit. Për shkak të situatës së krijuar Ministria e Mbrojtjes ka publikuar pikat e kontaktit për administrimin dhe menaxhimin e ndihmave për njerëzit të dëmtuar nga reshjet e shiut, si dhe numrat e llogarisë në rast të kontributit financiar. Pikat e grumbullimit të ndihmave dhe donacioneve do të jenë pika kryesore në Komandën Mbështetëse, me adresë, Vaqarr Tiranë (Me pika kontakti Major Orges Baholli, email: orges.baholli@aaf.mil.al cel. +3556738894449 dhe Major Merfilla Kamberaj, email: xhoelkamberaj@yahoo.com cel. +355675546048); Kapiten Ermal Nako, email: ermal.nako@aaf.mil.al cel. +355695444763; Pika alternative, për grumbullim do të jetë batalioni i Mbështetjes së SHPPFA me adresë, Rruga e Dibrës, Garnizoni "Skënderbej" (Me pika kontakti Kapiten Dilsiona Kuro, cel. +355693956188; Kapiten Jonion Shkëlqimi, email: jonion.shkelqimi@aaf.mil.al, cel. +355665976161; Kapiten Vilma Kuro, email: vilma.kuro@aaf.mil.al, cel. +355694783007); Shpërndarja dhe transporti i ndihmave do të bëhet nga Batalioni i Transportit të Komandës Mbështetëse, Pezë-Helmës Tiranë (Pika kontakti N/Kolonel Ylli Pritfi, email: ylli.pritfi@aaf.mil.al, cel. +355674057461; Kapiten Jetmir Cami, email: jetmir.cami@aaf.mil.al, cel. +355675508051; Major Bekim Murja, email: bekim.murja@aaf.mil.al cel. +355686791130). Për koordinimin e këtij procesi, në Qendrën e Bashkuar Operacionale (QBO), do të funksionojë 24 orë, grupi koordinator në sektorin e vendit pritës, i përbërë nga Major Përparim Arriku, email: perparim.arriku@aaf.mil.al, cel. +355697491102; Ermal Dinoshi, email: ermal.dinoshi@aaf.mil.al cel. +355695299579; Major Erjon Skembi email: erjon.shkemi@aaf.mil.al cel. +355662065555; Toger Merzo Lenko, email: merzo.lenko@aaf.mil.al cel. +355695560314.

Qendra e ndihmave

Qendra e Pritjes dhe Administrimit të Ndihmave do t'u vijë në ndihmë të gjithë të interesuarave për dhënie ndihmash si: organizata ndërkombëtare, shoqata joqeveritare, grupime vullnetare etj., të cilët duan të japin kontributin e tyre për familjet e dëmtuara nga përmbytjet e ditëve të fundit.

Arbër Sulo

GREQI

Pak ditë pas megaoperacionit ku u sekuestrua një gomone e nisur nga Himara me 1.6 tonë kanabis dhe përfunduan në pranga 11 persona, policia greke ka ndër marrë edhe dy operacione të tjera antidrogë. Mësohet se gjatë këtyre operacioneve janë sekuestruar 29 kg heroinë dhe 234 kg marijuanë, ndërsa u arrestuan 5 shqiptarë dhe një vajzë greke. Sipas mediave të vendit fqinj, operacioni i parë ku u sekuestrua sasia e heroinës u zhvillua nga policia e Athinës, Selanikut dhe roja bregdetare. Burimet e mësipërme bënë me dije se hetimet intensive çuan në shkatërrimin e një rrjeti të specializuar për importimin dhe trafikimin e drogës, duke identifikuar e arrestuar anëtarët e saj. Në pranga përfunduan 2 shqiptarë të moshës 32 dhe 34 vjeç, si dhe një 29-vjeçar greke. Droga u gjet në një tavernë në Kalyvia Thorikou, e cila përdorej si bazë për aktivitetin kriminal. Heroina, e cila sipas mediave greke vinte nga Shqipëria dhe Turqia dërgohej në këtë tavernë dhe më pas ripaketohej dhe përzihet me substanca të tjera. Në total u gjetën dhe u sekuestruan 59 pako heroinë me peshë 28 kg dhe 708.5 gr. që u gjet e fshehur në tavernë. Autoritetet gjetën gjithashtu 5 kg e 180 gr substanca pëzierëse, 1 shishe me 520 gr lëndë e paidentifikuar, rreth 4600 euro, telefona celularë, karta identiteti dhe patenta. Në krye të këtij rrjeti mëso-

Kapen edhe 234 kg marijuanë në kufi, prangosen 3 shqiptarë të tjerë

Trafiku i heroinës nga Shqipëria dhe Turqia, arrestohen 2 shqiptarë e 1 greke

Operacioni, 29 kg heroinë u sekuestruan në një tavernë



Heroina e sekuestruar në Greqi

het se ishte 32-vjeçari shqiptar, identiteti i të cilit, ashtu sikurse edhe të dy personave të tjerë të arrestuar nuk është bërë ende i ditur. Për 32-vjeçar shqiptar dhe vajzën greke mësohet se ekzistonin urdhra arresti nga Prokuroria e Athinës, për akuzat e pjesëmarrjes në organizatë kriminale dhe trafik droge. Ndërkohë, në operacionin e dytë të zhvilluar në kufirin greko-shqiptar u

sekuestrua një sasi prej 234 kg marijuanë. Lënda narkotike u kap në fshatin Vasiliko të Janinës. Mësohet se droga transportohej me një automjet për në tokën greke. Burimet nga autoritet greke pohuan se gjatë këtij operacioni janë prangosur 3 shqiptarë dhe se vijon puna për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë që mund të jenë përfshirë në këtë aktivitet kriminal.

ITALI

Autoritetet italiane kanë shkatërruar një bandë italo-shqiptare, pjesëtarë të së cilës ishin 10 persona. Kjo organizatë kriminale, në mesin e së cilës ishte edhe një afrikan, ishte lidere në mikro-tregun e provincës së Bericas në Vicezna, në shitjen e kokainës dhe marijuanës. Mësohet se kreu i kësaj bande ishte 39-vjeçari shqiptar Ahmet Balla, ndërsa krahu i djathtë i tij ishin dy nipërit. Bëhet fjalë për vëllezërit Mario dhe Sabiano Kërtusha, përkatësisht 26 dhe 23 vjeç.

TIRANË - Një zyrtar policie është arrestuar dhe policia, pas një hetimi disamujor nga prokuroria për trafikun e 2.5 tonë drogë në Ankona, Itali. Mbrëmë, me urdhër të Prokurorisë së Krimeve të Rënda janë ndaluar disa persona, mes të cilëve nënkomisari i policisë së Fierit, Festim Lelaj, i cili konsiderohet në rolin e organizatorit, të dyshuar si përgjegjës për trafikimin e 2.5 tonë lëndë narkotike kanabis nga porti i Durësit në drejtim të Italisë, ngjarje e ndodhur në janar 2017. Prokuroria nisi hetimin, pasi autoritetet italiane në Ankona zbuluan një kamion me lëndën narkotike, i cili drejtohej nga shtetasi shqiptar, Dhimo Koraj. Në bazë të informacionit fillestar, të përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë

2.5 tonë drogë drejt Italisë, prangoset nënkomisari i policisë së Fierit



nga homologët italianë, Prokuroria për Krime të Rënda zhvilloi hetimin. Bazuar në veprimet procedurale, deri më tani është arritur të identifikohen dhe arrestohen apo ndalohen disa persona, të cilët dyshohen se janë pjesë

e këtij grupi të strukturuar kriminal. Fillimisht janë arrestuar para pak kohësh shtetasit Demo Progonati, Euron Hoti dhe Malton Lleshi, të cilët tashmë hetohen me masë e sigurimit arrest në burg për shtetasin Aurel Lazaj, masë e cila është ekzekutuar para pak ditësh. Ndërkohë është nxjerrë urdhër ndalimi për shtetasit: Festim Lelaj, aktualisht nënkomisar në komisaratin e Fierit, Skënder Siceqa dhe Arbi Mustafa, të cilët janë ekzekutuar nga policia ditën e djeshme.



Aplikim për të përfituar Statusin e Naftëtarit

Njohohen të gjithë punonjësit dhe ish-punonjësit e shoqërisë Albpetrol sh.a se, bazuar në Ligjin Nr.8/2017 "Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe Gazit" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.425 datë 10.05.2017, se ka filluar shpërndarja e dokumenteve për Statusin e Naftëtarit. Personat e interesuar që të pajisen me dokumentet përkatëse duhet të paraqiten pranë njëres prej qendrave të punës ku kanë punuar dhe të fillojnë procedurën.

Shoqëria Albpetrol sh.a sqaron të gjithë personat e interesuar se disponon dokumentacion për periudhën që kanë punuar në shoqërinë Albpetrol sh.a nga viti 1994 e në vazhdim. Për periudhën përpara vitit 1994, dokumentet mund të merren pranë Sigurimeve Shoqërore ose arkivave të tjera.

Personat që duan të pajisen me vërtetim të posaçëm zyrtar për periudhën përkatëse duhet të plotësojnë formularin përkatës, i cili mund të shkarkohet në adresën www.albpetrol.al/statusi-i-naftetarit/ ose mund të tërhiqet fizikisht pranë qendrave ku kanë punuar.

Formulari i plotësuar duhet të dorëzohet në qendrat ku keni punuar së bashku me një kopje të librezës të punës ose mund të dërgohet me postë në qendrën përkatëse.



Njoftim i ALBtelecom Sh.a.

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së lëvizshme se duke filluar nga data 15 dhjetor 2017:

- Do të ofrojë dy paketa të reja 4 javore për të gjithë pajtimtarët me parapagesë:
 - Paketa Super 1300 do të përmbajë: 2,500 minuta të vlefshme drejt operatorëve kombëtarë; 2,500 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 20 minuta ndërkombëtare; 250 SMS kombëtare/ndërkombëtare; 8 GB Internet; të përdorshme përkatësisht 5 GB me shpejtësi 3G/4G dhe 3 GB vetëm me shpejtësi 4G; si edhe ALBtv Mobile dhuratë; të vlefshme për 28 ditë; me çmim 1,300 Lekë (me TVSH).
 - Paketa Super 1900 do të përmbajë: 3,000 minuta të vlefshme drejt operatorëve kombëtarë; 3,000 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 60 minuta ndërkombëtare; 300 SMS kombëtare/ndërkombëtare; 11 GB Internet; të përdorshme përkatësisht 8 GB me shpejtësi 3G/4G dhe 3 GB vetëm me shpejtësi 4G; si edhe ALBtv Mobile dhuratë; të vlefshme për 28 ditë; me çmim 1,900 Lekë (me TVSH). Abonentët të cilët e aktivizojnë këtë paketë përfitojnë paketën më të re të internetit EXTRA me 10 GB internet falas.
- Paketa ekzistuese 4 javore Super 1000 për numrat me parapagesë do të ndryshojë dhe njësitë e përfshira në këtë paketë do të jenë: 1,000 minuta drejt operatorëve kombëtarë; 1,000 minuta drejt ALBtelecom Fiks; 100 SMS kombëtare/ndërkombëtare; si edhe 6 GB Internet; të vlefshme në shpejtësi 3G/4G; me vlefshmëri 28 ditore; me çmim 1,000 Lekë (me TVSH).
- Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën 1000 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin këtë paketë të pandryshuar deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së kësaj pakete.
- Paketat ekzistuese 4 javore Super 500-1 dhe Super 700 do të mbeten të pandryshuara.
- Paketat 4 javore Super 500-2, Super 1200, Super 1500 dhe Super 2000 nuk do të ofrohen më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë njërin prej këtyre paketave aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin ato deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

KAOS NE SHENDETESI REAGIMET

Shkaqet, mbingarkesa dhe mosrespektimi i kontratës së punës

"Tërmet" në QSUT, dorëhiqen tetë mjekë të Urgjencës

Petrit Vargu: Zv.ministrja s'na thirri në takim

Voltiza Duro

Ditën e djeshme, 8 mjekë të Urgjencës Qendrore në QSUT kanë njoftuar se do të japin dorëheqjen për shkak të kushteve të rënda të punës. Në shkresën që i kanë dërguar drejtorit të përgjithshëm të kësaj qendre spitalore, Enkelejd Joti, mjekët kanë listuar të gjitha arsyet që i kanë çuar në marrjen e këtij vendimi. "Kushtet e punës së stafit mjekësor nuk plotësohen bazuar në kontratën punëdhënës-punëmarrës. Mbingarkesa me të sëmurë të shtruar që qëndrojnë mbi 48 orë në Urgjencë për mungesë vendesh në pavionet e tjera e moszbatimi i urdhrave të nxjerrë nga drejtoria, kemi marrë vendim që të tërhiqemi nga pozicioni ynë i punës, duke lajmëruar 30 ditë përpara", - citohet në shkresën dërguar edhe Presidentit, kryeministrit e ministres së Shëndetësisë. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Petrit Vargu, një prej mjekëve të Urgjencës që ka firmosur dorëheqjen tregon disa prej problematikave kryesore me të cilat ata përballen përditë në vendin e punës. Gjithashtu, ai thekson se shefi i Urgjencës nuk ka të drejtë të flasë në emër të mjekëve që firmosën peticionin e bën me dije se këta të fundit nuk kanë qenë prezent në takimin që zhvilloi zv.ministrja e Shëndetësisë, Mira Rakacolli pas letrës së dorëheqjes kolektive. Vargu më tej thotë se nëse situata nuk përmirësohet, do të heqë dorë nga pozicioni i punës. Respektivisht 8 mjekët që kanë dhënë dorëheqjen janë: Petrit Vargu, Elton Calliku, Petrit Gjorgji, Besmir Kocia, Jonida Kito, Egërem Hasani, Afrim Yzeiraj dhe Etimomena Bracaj.

Cila ishte arsyeja që ju firmosët letrën e dorëheqjes nga QSUT?

Natyrisht e kam firmosur këtë peticion e jam njeriu që kam denoncuar i pari këtë drejtim të gabuar që ka marrë shëndetësia shqiptare. Ne jemi mjekë dhe kemi një kod



Mjeku i Urgjencës, Petrit Vargu

pune dhe një ndërgjegje. Nëse duam të jemi moskokëçarës, mund të vijmë në punë, mbarojmë 8-orarëshin dhe largohemi në shtëpi. Por mjekët janë ato grupe profesionale, që kanë një jetëgjatësi më të shkurtër dhe për këtë asnjëri nuk ia di sakrificat mjekut, pavarësisht stresit që kalojmë për jetën e pacientit që na është besuar.

Sa të vështira paraqiten kushtet në të cilat punojnë mjekët e Urgjencës në këtë qendër spitalore?

Kushtet e vështira nuk janë për ne, por për pacientët. Ne nuk jemi si ata që drejtojnë, pasi për ta rëndësi ka që të mos merren vesh problemet nga media e gjithçka

shkon fjollë. Por, ne, mjekëve të Urgjencës së QSUT-së na vret ndërgjegjia, sepse çdo ditë që kalon, ka më pak medikamente. Dhomat nga dyshe, kanë kaluar në dhoma katërshe. Na vret ndërgjegjia sesi njerëzit që vijnë në Urgjencë rrinë nëpër stola e presin me ditë për t'u shtruar në spital. Sipas shifrave që kam siguruar nga kolegët, janë mbi 60 kartela që janë në pritje për t'u shtruar", - tha Vargu.

Që të reagoj, duhet të dish. Në fillim kanë kundërshtuar që ekziston një letër e tillë e më pas kur nuk kishin më se çfarë të thoshin, nxorën variantin sesi ka arritur kjo letër te mediat. Si mund të reagojmë kur pacientët janë nga 5-6 veta në një dhomë në zonën e kuqe dhe nga 4 veta në zonat e tjera. Kjo është anti-higjienike, edhe në burg nuk qëndrohet ashtu.

A jeni të kënaqur me pagat dhe a qëndroni jashtë orarit në krye të detyrës?

Cili është reagimi juaj në lidhje me deklaratën e shefit të Urgjencës?

I vetmi mjek që nuk firmosi peticionin e kanë nxjerrë për të folur në emër të mjekëve që firmosën dhe kjo është qesharake, pasi ai nuk ka të drejtë të flasë.

A ishit të pranishëm gjatë takimit të mjekëve të Urgjencës me zvmministren e Shëndetësisë, Mira Rakacolli pas publikimit të peticionit?

Unë nuk isha, sepse takimi ishte selektiv. Nuk ishte i pranishëm asnjë nga mjekët që organizuan peticionin.

Cili është reagimi i Drejtorisë së QSUT-së në lidhje me peticionin tuaj?

Jashtë orarit absolutisht jo. Ndërsa në lidhje me pagat mund të them se pagat e mjekëve janë si pagat e gjithë shqiptarëve të tjerë, ne e dimë varfërinë ku ndodhet populli, por nuk kërkojmë luks. Kërkojmë dinjitet.

Mendoni se pas peticionit të mjekëve të Urgjencës, do të përmirësohet situata?

Kjo situatë, ashtu siç ka ndodhur shpeshherë, do të përmirësohet në mënyrë artificiale, por nuk ka vizion, nuk ka shpresë që të përmirësohet përfundimisht, pasi mungon strategjia dhe taktikat. Nuk ka asgjë të re, e me "frymën e shenjtë", asgjë nuk përmirësohet.

A do tërhiqeni nga vendi juaj i punës nëse situata nuk përmirësohet?

Kjo është një zgjedhje individuale, por unë personalisht po.

EDMOND ZAIMI

NUK KEMI DHËNË DORËHEQJEN, KËRKESË PËR PËRMIRËSIM KUSHESH

Shefi i urgjencës së QSUT, Edmond Zaimi, në një deklaratë për mediat ka theksuar se mjekët nuk kanë dhënë dorëheqjen, por thjesht kanë dorëzuar një peticion për përmirësimin e shërbimit. "Ne nuk kemi dhënë dorëheqje në '97, kjo është një kërkesë e jonë për të rregulluar problemet nëpërmjet drejtorisë. Është puna e drejtorisë më tej që do të zgjidhë problemet duke përfurcuar të gjitha hallkat e sistemit. Situata është e ngarkuar, me shumë të sëmurë nga gjithë Shqipëria", - tha Zaimi.

TRITAN SHEHU

"Dorëheqja, ngjarje e rëndë për sistemin shëndetësor. Larg parametrave europiane"

Pas dorëheqjes së mjekëve të Urgjencës së QSUT-së, ka reaguuar edhe deputeti i Partisë Demokratike, Tritan Shehu, i cili e vlerësoi këtë si një ngjarje të rëndë për sistemin shëndetësor në vend. Ai theksoi se nuk funksionojnë mekanizmat kryesorë të sistemit dhe kjo sjell vështirësi në punën e personelit mjekësor, e gjithë pesha shkarkohet në QSUT. "Nga ana tjetër, drejtuesit shtetërorë kërkojnë të shkarkojnë të gjithë përgjegjësinë e presionin publik padrejtësisht mbi personelin shëndetësor, që veçse kërkon të bëjë më të mirën e mundshme", - thekson deputeti. Sipas tij, të tilla situata e probleme janë në themel të eksodit masiv të mjekëve, të kërkesave e protestave të tyre të drejta, të cilësishë së shërbimit të ofruar. Ky i fundit sipas deputetit, qëndron shumë larg parametrave europianë. Shehu gjithashtu tregon se ka mungesa të mëdha në teknologji e materiale, duke shtuar se rrogat e mjekëve janë minimale përballë punës së vështirë që ata kryejnë.

BARDH SPAHIA

"Shëndetësia në kaos, jemi në mbështetje të mjekëve deri në zgjidhjen e situatës"

Ndaj kësaj ngjarjeje ka reaguuar edhe deputeti demokrat, Bardh Spahia, i cili tha se sistemi shëndetësor ndodhet në një amulli të plotë e në një kaos total. Nga ambientet e Urgjencës së QSUT-së, ai deklaroi se në të gjitha aspektet ka mungesa të theksuara. "Një sistem shëndetësor në çakodim të plotë me mungesa të theksuara në të gjitha aspektet sa u përket medikamenteve, pajisjeve mjekësore, por edhe kushteve të tmerrshme në të cilat janë të detyruar të punojnë punonjësit e sistemit shëndetësor shqiptar, duke filluar nga mjekët, infermierët, personeli tjetër i sistemit shëndetësor", - tha Spahia. Më tej, ai theksoi se ka pasur vendosmëri absolute të mjekëve të QSUT-së për të ngritur zërin për kushtet e patolerueshme në të cilat janë të detyruar të punojnë. "Po përballen çdo ditë dhe natë me kushte ekstremisht të vështira, të cilat tashmë është e qartë që nuk janë dakord të vazhdojnë dhe t'i pranojnë", - shtoi deputeti i PD-së. Ky i fundit ofroi mbështetje të plotë për mjekët e Urgjencës së QSUT-së, deri në plotësimin e kërkesave dhe ndryshimin e situatës që sipas Spahias, për këtë mjafton anulimi i koncesioneve korruptive prej 400 mln euro.





Volta Duro

Pas ditën e së djeshmes, pas letrës kolektive për dorëheqjen e 8 mjekëve, Drejtoria e QSUT-së reagoi në lidhje me situatën, ku bëri me dije se puna nuk është ndërprerë për asnjë moment. "Drejtoria e Qendrës Spitalore Universitare 'Nënë Tereza' sqaron opinionin publik se puna në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme nuk është ndërprerë për asnjë moment. Të gjithë mjekët që punojnë në këtë shërbim janë në punë dhe në asnjë rast nuk është ndërprerë shërbimi ndaj pacientëve", - sqaron ajo. Më tej, drejtoria theksoi se Urgjenca furnizohet rregullisht me barna dhe materiale mjekimi sipas kërkesave, duke kundërshtuar kështu disa prej deklaratave të bëra ditën e djeshme. Më tej, QSUT u ka bërë thirrje qytetarëve që të drejtohen sa më pranë vendbanimeve të tyre për të marrë shërbim, me qëllim reduktimin e flukseve të shtuara dhe mbingarkesave të pancevojshme në këtë qendër spitalore. "Duke falënderuar qytetarët për besimin që kanë tek ekipet mjekësore të QSUT-së, njëherësh u kërkojmë atyre që të drejtohen sa më pranë vendbanim-

Nora Malaj e Petrit Vasili: Kryeministri s'ka mbajtur premtimet për shëndetësinë

Reagimi i QSUT: Për asnjë moment nuk është ndërprerë shërbimi



Drejtoria e QSUT



Letra kolektive e dorëheqjes së mjekëve

it të tyre për të marrë shërbimin mjekësor. Pacientët do të drejtohen në qendrën tonë spitalore vetëm kur të jetë e nevojshme. Edhe një herë i garantojmë qytetarët se do të jemi gjithnjë në gatishmëri për t'u shërbyer sa herë të kenë nevojë", - shprehet drejtoria në reagimin e saj. Pas letrës kolektive të dorëheqjes së 8 mjekëve të Urgjencës së QSUT-së, zv. ministria e Shëndetësisë, Mira Rakacol-

li, organizoi një takim ditën e djeshme me këta të fundit për të gjetur një zgjidhje e për të dëgjuar problematikat, që i çuan deri në marrjen e një vendimi të tillë. **REAGIMI I LSI**
Pas reagimeve nga deputetët e PD-së mbi dorëheqjen e 8 mjekëve të Urgjencës, ka reaguuar ashpër edhe LSI. Kreu i grupit parlamentar të LSI, Petrit Vasili, e ka cilësuar programin e shëndetësisë falas si një

mashtim kriminal nga ana e kryeministrit Edi Rama. "Mashtimi më i pacipë që shqiptarëve u është bërë ndonjëherë është shëndetësia falas, që premtoi me zurmë të madhe kryeministri. Me padijen e tmerrshme, tashmë të njohur të tij, kryeministri nuk la budallallëk pa thënë për shëndetësinë, pasi dihet që kupton 'shumë' nga mjekësia", - shkruan Vasili në rrjetin social "Facebook". Më tej, ai ka thek-

suar se shëndetësia jo vetëm që nuk është falas, por është në ditët e saj më të këqija pas kalimit të buxhetit për 2018-ën. Më tej, edhe deputetja e po kësaj force politike, Nora Malaj në një komunikim nga selia e LSI tha se kryeministri Edi Rama nuk ka mbajtur asnjë premtim për sektorin e shëndetësisë. Ajo u shpreh se mjekët janë dorëzuar e po ngrënë zërin, pasi kushtet ku punojnë janë skandalozë. "Kushtet që punojnë mjekët janë të pamotivuar. Ndaj u janë drejtuar me letra kryeministrit dhe presidentit. Kërkesa e tyre për kushte kushtesh dhe vendesh, që janë të drejta dhe shumë njerëzore. Ata mbështeten në kodin e punës. Sot më shumë se kurrë në emër të LSI kemi në mbështetje të plotë për ta parë qartë problemin e mjekësisë si një fjalë e pambajtur e kryeministrit", - tha Malaj.



REPUBLIKA E SHQIPERISE INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

SHPALLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelitimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organike dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelitimit".

I - Shpall vendet vakante për pozicionet:

1. Drejtoria në Drejtorinë e Menaxhimit të Çështjeve dhe Mardhënieve me Median dhe Publikum
Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

2. Drejtoria në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mëshpëtimore

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" për Ekonomi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në nivel drejtues e menaxherial.

3. Specialist Sekretarie Gjyqësore

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

4. Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të arsimit të Lartë, në Degën Gjuhë -Letërsi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

5. Përkthyes

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Gjuhë të Huaja, Dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimum 5 vjet eksperiencë në përkthim Shqip- Anglisht - Shqip.
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombetare.

6. Koordinator për mediat dhe mardhënitë me jasthtë

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit të arsimit të Lartë në Drejtësi/ Gazetari/Gjuhë-Letërsi etj.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në fushën e mardhënieve me median/ mardhënitë me jasthtë.

7. Specialist për prirjen me popullin

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit të arsimit të Lartë në Drejtësi.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

II - Rishpall vendet vakante për pozicionet:

8. Specialist Financë/Buxhet

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

9. Specialist i Burimeve Njerëzore

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

10. Specialist IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inzhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client etj.
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Eordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

11. Specialist Protokoll/Arkive

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me Certifikate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 15 Dhjetor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 11 Dhjetor deri më 15 Dhjetor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të notorizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnimet, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

INTERVISTA

Fatmira Nikolli

Një ditë para se të ikte, vetëm 24 orë përpara se të ndërronte jetë, la këtë skicë portret për mikun e tij. Petrit Ruka thotë se nuk e di se ç' i shkrep në kokë Aleksandër Lalos, kur i kërkoj një stilolaps kamarierit të kafes dhe tha: Petrit, do të të bëj një skicë! E firmosi dhe ia dha. Ruka e palosi dhe e futi në xhepin e xhakëtës. Sipas Lalos, ky ishte Ruka në atë çast, diku rreth orës 19:30 të datës 19 nëntor 2017. Të nesërmen do të ndaheshin fizikisht njëherë e përgjithmonë në orën 10.55 përpara Teatrit Kombëtar. Kanë kaluar pak ditë që kur Aleksandër Lalo, pasditen e një të diele na ktheu shpinën, pothuaj me përcimim. Kur mendon imazhin e tij, pyetja e parë që të shkrep në mendje, është në i duam ne të ndryshmit, apo bëjmë sikur? Dhe pse i etiketojmë si të çmendur ata që janë ndryshe nga ne, më të guximshëm se ne, më të mirë se ne, ose, së paku më të vërtete se ne? Aleksandër Lalo ishte antikongformist. Me siguri, e dinte se fjalët e mira e të pamerituara për ndokënd do e ndihmonin më shumë se e vërteta që ziente në kokën e tij. Ai e dinte, por nuk e zgjodi. Sa shumë njerëz i mbajtën mëri, kur u tha se notat e tyre nuk vlenin, në atë muzikë komerciale që askush nuk e mbante mend një vit më vonë. Një vijë melodike që krijonte zigzage të rrëmujshme. Një kaos që shoqëron trupa të zhveshur. Të tjerëve u pat thënë se filmat e tyre qenë pa kuptim, që mund të ishin gjithçka po jo kine-ma. Atë ditë të diele, të fundit të jetës së tij, i pat thënë mirupafshim Margës, kur mbyllet për herë të fundit, derën e shtëpisë. Shkallëve do të fshinte syzet. Kafën e mëngjesit e gjerbi me mikun e tij, Petrit Ruka, duke bërë të njëjtat biseda të zakonshme. Nëntori po ikte, për të ardhur dhjetori. Ruka, kujton sot për "Gazeta Shqiptare", të dielën me mikun tij.

- Si ishte dita e fundit e Lalos ?

Atë ditë e kemi ndarë bashkë. Pimë kafën bashkë në mëngjes, si çdo ditë. E pimë në kafe se kohët e fundit kishte filluar të ndihej i lodhur. Kish-te filluar të ankohej. Thoshte shpesh nuk jam mirë, por këto kohë ndihej i lodhur, i mpakur, më frymëmarrjen kishte probleme e kishte filluar të përtonte, ai njeri që nuk përtonte kurrë. Ai kish-te dëshirë gjithnjë të ikte larg. Atë ditë, unë do të ikja në një aktivitet të shoqatës "Labëria". I thash-e eja më shoqëro. Tha po të shoqëroj deri te Opera, i thash-e eja më tutje se të ndryshken këmbët. Më shoqëroi deri te pedonalja te teatri. U ul të priste në një kafe. Pas 15 minutash ai më mori në telefon, siç ishte i paduruar dhe tha: "Hë ore, mbarove?". Jo, - i thash-e, - ende nuk kemi filluar. "Ehu, ica unë", - i tha.

- Ku u sëmurr?

Telefonata e dytë, ishte nga spitali. Shkoi deri afër piramidës, aty pati një gjendje të fikë-ti. U kujdesën disa qytetarë. E çuan në urgjencë. Nga spitali shtetëror e çuan te një privat dhe aty ishte pesë orë ferri. Deri në orën 9 të mbrëmjes kur u shua.

Ishte e habitshme. Ishte mirë, nuk vuan-te nga ndonjë gjë serioze. Edhe nga zemra ishte kontrolluar 4-5 muaj më parë, kish rezultuar mirë. Ishte i ktheu tronditëse, e hidhur, e befte. Ishte një vdekje tinëzare.

- Si u përjetua ikja e tij?

U tronditëm të gjithë, në miqtë e familja. Pas vdekjes, zbulohet si me magji tërë jeta e një nje-riu. Bëhet bilanci i tij dhe reagimi për ikjen e Lalos ishte shumë masiv. Kam marrë 600-700 mesazhe. Më ka bërë përshtypje reagimi në rrjetet sociale, sepse është i singërt, ngase nuk është një reagim që bëhet për t'u botuar në media. Atëherë kam kuptuar se ku qëndronte sekretit që ishte kaq i dashur për njerëzit e thjeshtë. Me sa duket, njeriu i thjeshtë, anonim, ai që është diku atje, ka si idhuj, ka ca simbole. Do dhe ka nevojë të mishërohet diku, atë që ka në shpirt, ai nuk ka mundësi ta realizojë, nuk ka mundësi të rebelohet. Zëri i tij nuk dëgjohej. Njerëzit gjenin te Lalo atë rebelizim që mund ta shprehin vetë, sepse nuk kishin një mikrofon, nuk kishin një zë, as nuk kishin kush t'i dëgjonte.

- Ai ishte antikongformist.

Te Lalo mishërohehin qindra e mijëra njerëz të thjeshtë në revoltën e tyre për artin komercial, të cilin ai si asnjë artist tjetër e kritikonte, i jepte zë kritikës. I qëndronte problemit përballë, ishte rebel e kritik, ndaj këtij arti, ndaj Ministrisë së Kulturës, ndaj Festivalëve të RTSh-së, i bënte gjyqin atij festivali. Nuk ishte kongformist. Ky skaner që u bënte eventeve publike e bënte Lalon të

Antikongformisti Aleksandër Lalo

"Dita e fundit e kompozitorit që tha: Muzika tallava do zhduket si sobat bullgare"



Në foto: Petrit Ruka

rrëzonte, të ishte i meritur me shokët e tij, me orkestrën, punonjës të RTSH-së, po të ishte kongformist nuk do t'i interesonte të përplasej me 10, 20, 30 drejtues me të cilët, donte apo nuk donte ishte e vetmja mundësi që të bashkëpunonte që të realizonte koncertet e tij. Lalo ishte një femijë i singërt që i thoshte gjërat që mendonte, pa menduar nëse mund të të ngelte qejfi. Ua thoshte edhe miqve më të afërt. Ne nuk jemi shoqëri

ende e emancipuar kur njeriu është vetvetja, ku njeriu e artisti ka individualitet, shumica e artistëve janë ende kongformistë. Flirtojnë me pushtetet, me segmente të pushteteve, me ata që kanë në dorë projekte e financime. Në Shqipëri është bërë moto, "mos fol se do të të duhet". Ç'të duhet që flet? Kësh-tu jemi, këta jemi, kjo sofër është e do ulesh me ta, do hash me ta. Unë them se ky ishte sekretit që Lalon e donin.

Sekretit tjetër, është se Lalo kishte magjinë e të thjeshtës. Artistët e mëdhenj janë të thjeshtë. Ata nuk i komplikojnë vlerat e tyre, nuk i kthejnë në rebushe që ti të jesh vazhdimisht mes pikëpyetjeve. Sekretit i muzikës së tij është se ishte e thjeshtë. Këngët e Lalos i di e gjithë Shqipëria.

Ishte një njeri që luante me elemente shqiptare, është melodist, sepse shpirti i këngës është melodia. Si njeri ishte i vërtetë, por i tillë ishte edhe në muzikë. Ka një mister në këngët e tij. Por mrekul-lia është që me atë pak miell, bën një dritë, bën një gëzim.

- Është kujtuar këto ditë një përplasje që ai pati me ministrin e Kulturës?

Lalo nuk është se e kishte me Mirela Kumbaron, në kuptimin individual. Ishte institucionale. Do them diçka që e dinë vetëm miqtë e tij. Disa ditë pas asaj përplasjeje, ai kishte datëlindjen dhe i erdhni një tufë me lule. Ministrja vuri i kishte dërguar një tufë të madhe me lule në shtëpi. Lalo u prek shumë. Unë nuk e kam me të tha, nuk e kam me Mirelën, e kam me fenomenin. Mendoi se në një farë mënyre ishte vlerësimit.

- A ishte i vetmuar ai duke qenë se ka natyrë kritike?

Ishte një njeri që kishte dy a tre miq të afërt me të cilët dilte e zbrazej. Sigurisht që ishte i zhgënjyer. Dhimbja e tij më e madhe ishte muzika, e cila po katandisej. Ishte ndër të vetmit që fliste, ishte futur në këtë betejë dhe fliste gjithmonë. Edhe në televizion ai fliste sidomos për tekstat që

Rrëfimi i Petrit Rukës: Si u njoh me Margën në Kukës dhe dashuria e tij për muzikën

Miku i ngushtë rrëfen bisedit me të: Puna që la përgjysmë, një muzikë filmi për femijë



Në foto: Aleksandër Lalo

janë mizerabël që janë të mbështetura në dy a tri fjalë pa kuptim. Për muzikën që mbeti në duar amatorësh kishte shumë dhimbje. Megjithatë ai kishte një bindje që një ditë, e gjithë kjo do binte. E gjithë kjo llovi e madhe, kjo ngrehinë e madhe, e rreme, e pistë, e padenjë për Shqipërinë që vjen nga një traditë e shkëlqyer, do bjerë një ditë, siç ranë sobat bullgare, - më thoshte mua. Në fillim u sulën të gjithë, u blenë 200 mijë soba bullgare. Sot s'ka

asnjë sobë bullgare në treg, më thoshte. I njëjti proces do të ndodhë dhe ka të drejtë. Dhe po e shohim se do bjerë. Vetë televizionet po kërkojnë këngë më të mira, iu kthyen muzikës live në festiva-le. Kështu është shoqëria njerëzore, bën ca hapa pas dhe e kap veten.

- Ai ka bërë edhe muzikë filmash. Si e gjykon atë muzikë?

Jo vetëm ka bërë, por është pa dyshim bashkë me Kujtim Laron dy vjet më të mëdhenj të muzikës së filmit. Filmi shqiptar ka plot mungesa, është modest në kamera e dramaturgj, por filmi shqiptar ka vetëm diçka të padiskutueshme, muzikën. Edhe vetë të huajt e thonë, se e vetmja që nuk mund të anatohet, e anashkalohet, është muzika e filmit. E denjë për të qëndruar me muzikën e filmit në gjithë botën. E këtu ku kanë sekretit, nga Ceska Zadeja te Limos Dizdari, dy vjet e kësaj muzikë pa dyshim kanë qenë Kujtim Laro e Aleksandër Lalo.

- E vlerësonte veten për muzikën e filmit?

Kur i thoshin që ke bërë muzikë të mirë e je një ndër kompozitorët më të mirë të muzikës së filmit, ai thoshte jo, është Kujtimi i pari. Fliste për Kujtimin me një nderim shumë të madh. Këtë nuk e thoshte për të rënë në sy por sepse e besonte. Ka pasur fatqesinë që nuk i janë dhënë filmi shumë të mirë. Nuk i është besuar një film si "Nëntori i dytë", as si "Përballimi", "Lulëkuqet mbi mure". U dhanë filmi më të dorës së dytë a të tretë, sepse Lalo ishte në Kukës e kishte edhe rrethana të tjera. Ajo që të habit është se ai ka sh-

këlqyer në film, të cilët nuk janë të rëndësishëm shumë. I jepnin film për femijë, por ai ka shkëlqyer, edhe pse ishin filmat të vegjël, në kuptimin e temave. Ai ka bërë një mrekulli me filmin "Tomka dhe shokët e tij", që ka një muzikë të mrekullueshme. Nuk po them pastaj për "Dimrin e fundit". Po ju kujtoj muzikën e "Emblemës së dikurshme" që është po ashtu e mrekullueshme. Ishte skrupuloz që nuk nxirrte nga duart e tij gjëra që nuk ishin të denja. Aleksandër Lalo krijoi në 30 e ca vite rreth 800 këngë dhe muzikë për më shumë se 30 filma artistikë, duke bërë një emër të shquar në muzikën shqiptare.

- Së fundmi, po bënte muzikë filmi?

Së fundmi po punonte për një muzikë të një filmi që kam xhiruar unë. Kam xhiruar një film për femijë, në Përmet. Është 30 minutash, e mori me shumë qejf sa kthehej deri në bezdi. Kërkonte të dinte çdo plan e çdo frazë. Tema e muzikës ka ngelur në pianon e tij, për mungesë fondesh. Lalo nuk pranoi ta bënte në mënyrë kompjuterike muzikën. Ai donte orkestrë, dhe për këtë duheshin 2 milionë lekë që ne nuk i kishim. Është pengim im që nuk arriti ta bënte. Është një dhimbje për mua që nuk do të jetë në premierë, nuk do ta dëgjojë muzikën e tij, nuk do ta shohë. Iku me brenë që nuk e realizoi. Do bëj një gjë shumë të bukur thoshte, jetonte më këtë gjë. Ne do të përpiqemi, janë ofruar dy a tre miq të tij ta bëjnë këtë punë falas.

Ai nuk bënte më këngë, por bënte skica simfonike. Është një kompozitor që ka bërë koncert 1 orë e gjysmë me muzikën e tij. Kishte shkruar 9 pjesë simfonike dhe koncerti që u bë te Katedraja Ortodokse ishte ndoshta më i bukur i këtyre 20 viteve të fundit.

- Si ishte njohur me Margën ai?

Marga është një grua shumë e urtë e shumë e dashur. I ka qëndruar gjithnjë pranë. Përfjetoj ikjen e tij në më dramatikë. U njohën në Kukës. Në natën e vonë një djalosh i hajthëm, vetëm 23 vjeçar, i diplomuar për muzikë, nisej për në qytetin e tjetër. Ishte fill i vetëm, shtrihet në krevat me gjithë rroba në të ftohtin e veriut.

Në Tiranë kishte filluar të bënte emër si një muzikant fin, ka marrë pjesë në festivalin e famshëm që quhet thjesht i 11-ti, ku ka edituar këngën e bukur "Vajzat dhe kompozitorit" me një ritëm e tekst të çuditshëm, ka bërë vullnetarish një orkestrë për cirkun që e dirigjonte vetë dhe shokët thonin se është kaq zremtues. Në gusht të vitit 1973 autobusi i linjës zvarritet maleve drejt veriut. Kruga deri në Kukës aso kohe zgjaste më shumë se sa linja Tiranë - Nju Jork. Aleksandër Lalo, që sapo ka mbaruar shkollën lartë ka lënë pas kryeqytetin ku ka lindur, fizarmonikën e tij të dashur, shokët, miqtë dhe një mal me ëndrra për të bërë këngë të bukura. Dega e Lidhjes së Artistëve në Kukës vendos ta bëjë kandidat të Lidhjes së rrethit. Muzikantit ngrihet në këmbë i falënderon thellësisht dhe u thotë se ka nja shtatë vjet që është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë. Po ata ngulin këmbë si dreqi. Mirë bër, atje je anëtar, pranoje që këtu të jesh kandidat. Dhe Sandri fliste me ajo dashuri për Kukësin e ngul këmbë se ato kanë qenë vitet më të bukura të jetës së tij. Ato të të vite. Pikërisht në ikje e sipër ai nje atij një vajzë të hijshme që sapo ka mbërritur si dentiste. Kukësi ia dha edhe këtë fat që qyhet Marga, dhe që do të bëhej shoqja e tij e mirë e jetës. Kur tregonte për puthjen e tij të parë midis moshës, thotë se pikërisht atë cast nëpër natën e rrallë kaloi si një vegim me turfullim një kalë i bardhë. Dhe shonte, nuk më besojnë, po kaloj vërtet një kalë i bardhë. Ndoshta "kali i Sandrit" ka kaluar vërtetë si një kalë i bardhë që ndilte fat për atë martesë të lumtur.

Opinion i Ditës

Nga Sali Berisha

Debati për datën e Çlirimit, Berisha thirrje shqiptarëve: Më mirë vonë se kurrë!

(Vijon nga faqja e parë)

... siç dihet, edhe sot vazhdon debati mbi saktësinë e datës së çlirimit, nëse kjo ka ndodhur më datë 28, për çka ekzistojnë të gjitha provat se kjo ishte data e pranuar fillimisht. Personalisht jam dakord me historianët se dita e çlirimit, e tërheqjes së ushtrisë gjermane nga Shqipëria mund të ishte secila nga ditët, nga data 17 nëntor e tutje. Madje, me logjikën qesharake të largimit të gjermanit të fundit nga Shqipëria, kjo datë mund të ishte 2 apo 4 e më shumë dhjetor.

Por data 29 nëntor, siç pretendon e majta shqiptare, ka simbolikë antishqiptare, pasi përfaqëson datën e falsifikuar nga Enver Hoxha, ndonëse ai vetë, jo vetëm që u instalua në krye të qeverisë së tij më datën 28 nëntor 1944, por edhe një vit më vonë ai festoi çlirimin po me datën 28 nëntor. Pra rëndësia e këtij debati qëndron në faktin se, Enver Hoxha falsifikoi edhe këtë datë, për ta njëjtuar këto festë jo me ditën e çlirimit, por me festën kombëtare të Federatës së Jugosllavisë, pra me ditën e shpalljes së saj nga J.Broz Tito në Jajcë, më 29 nëntor të vitit 1943. Diktatori Hoxha falsifikoi datën e çlirimit në mënyrë që, pas bashkimit si Republikë e 7-të me Federatën Jugosllave, Shqipëria do të festonte edhe ajo më 29 nëntor, së bashku me republikat tjera, jo Jajcën, por Çlirimin e saj.

Por në rast se për datën e çlirimit debati përsëritet çdo nëntor mjerisht, ende sot e kësaj dite jo pak shqiptarë dhe në tërësi e majta shqiptare, nuk janë ndalur dhe nuk ndalen dot në një aspekt tjetër themelor të kësaj date. Ata nuk janë ndalur në të vërtetën më të pamohueshme historike, se 28 nëntori i vitit 1944 shënoi jo vetëm çlirimin nga një pushtim i huaj, me saktë largimin e një pushtuesi të huaj nga Shqipëria, por dhe zëvendësimin e atij pushtimi me një pushtim tjetër të huaj dhe me një pushtim të brendshëm pasi, në fronin e pushtetit në Tiranë, u ul një klikë terroriste shqiptaro-serbe me projekt kryesor zhdukjen e shtetit të pavarur të shqiptarëve.

Sot historianë dhe studiues, vendas dhe të huaj, me botimet e tyre serioze dhe të shumta, të bazuara në mijëra dokumente të arkivave të vendit, të aleatëve dhe vendeve të tjera, kanë rishikuar historinë në dritën e të vërtetave të pamohueshme historike. Ata, me veprat e tyre të jetë të rëndësishme, kanë shkruar si rrezet e diellit brymën, malin e lartë të falsifikimeve të historiografisë hoxhiste. Prandaj sot, bazuar në të vërtetat historike shkencore është koha për reflektim të thellë nga çdo shqiptar kudo që jeton, për historinë tonë në tërësi, si dhe në rastin konkret, edhe rreth kësaj date.

Studimet, botimet e historianëve shqiptarë, seriozë e të lirë të këtij çerek shekulli, të bazuara në dokumente dhe raporte të kohës, kanë provuar në mënyrë shteruese se J.B. Tito dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë, themeluan me dy qëllime kryesore me të dërguarit e tyre në nëntor të vitit 1941 në Tiranë, për interesa të serbomadhisë, Partinë Komuniste të Shqipërisë. Qëllimi i parë dhe më kryesor ishte krijimi i kalit të Trojes, pra i një partie dhe lëvizje Jugosllave në Tiranë, të drejtuar dhe urdhëruar dhe përdorur prej tyre kundër çështjes shqiptare. Qëllimi i dytë ishte që, në zbatim të porositve të Kominternit pas sulmit nazist ndaj Bashkimit Sovjetik, kjo forcë dhe kjo lëvizje shqiptaro-serbe të mobilizonte shqiptarët në luftë kundër pushtuesve. Në këtë kontekst, është provuar se të deleguarit, komunistë serbo-malazë, shkruan programin e PKSH, pa i referuar as dhe një herë Kosovës dhe çështjes shqiptare. Ata de facto vunë në krye të PKSH Miladin Popoviçin dhe emëruan rreth tij Enver Hoxhën dhe vasalët e tij. Ata, siç pohon dhe vet Tito, themeluan, udhëhoqën dhe urdhëruan këtë parti dhe njësitë e saj partizane, si parti dhe lëvizje Jugosllave, gjatë gjithë luftës.

Tito dhe PKJ, me kalin e saj të Trojes PKSH në Tiranë, arriti me sukses të bllokojë bashkimin e shqiptarëve në Shqipëri dhe bashkimin e kombit shqiptar në tërësi, në luftën kundër pushtuesve. Ata, me ndihmën direkt të PKSH dhe Enver Hoxhës dhe shqiptarëve me origjinë nga Kosova, që u dërguan aty me mision si Padil Hoxha etj., arritën të vendosin Kosovën në vartësinë e PKJ, pavarësisht se Federata Jugosllave nuk ekzistonte.

Tito dhe PKJ, nëpërmjet lëvizjes së tyre Jugosllave që themeluan në Tiranë, realizuan sa më sipër jo vetëm duke përjashtuar tërësisht çështjen kombëtare nga programi i PKSH, por dhe duke imponuar anulimin e menjëhershëm të Marrëveshjes së Mukjes, injorimin dhe asgjësimin e Marrëveshjes së Bujanit, dërgimin e brigadave dhe divizioneve partizane të Shqipërisë në Kosovë me pretekstin e çlirimit të saj nga gjermanët. Por në të vërtetë ato hynë si pararojë e pushtimit të Kosovës nga divizionet serbo-malazëze dhe bashkautorë në vendosjen e saj në administrim ushtarak nga Tito dhe masakrat e mëdha ndaj shqiptarëve, si masakra e Tivarit etj..

Krahas këtyre, historianët dhe studiuesit kanë faktuar me dokumente se: udhëheqësit Jugosllavë dhe vegla e tyre Enver Hoxha, pas shtatorit 1943 de-graduan me qëllim luftën e shqiptarëve kundër pushtuesve në një luftë kryesisht vëllavrasëse civile dhe se PKSH, siç pranojnë unanimitet vetë Enver Hoxha dhe udhëheqja e tjetër e kësaj partie në Plevniun e Dytë të Beratit, zhatoi gjatë luftës një vijë politike terroriste, pra plepuri si një organizatë e tillë dhe se udhëheqja e saj kishte kryer, urdhëruar në dhjetëra e qindra raste akte të mirëfillta terroriste.

Këto studime, të bazuara në dokumente të panumërta, kanë provuar se serbët, Enver Hoxha dhe vasalët e tyre të tjerë shqiptarë në krye të ushtrisë partizane të Shqipërisë dhe Kosovës kryen gjatë luftës kundër pushtuesve, gjenocid dhe krime të rënda kundër njerëzimit ndaj shqiptarëve

Përveç këtyre, klika terroriste serbo shqiptare në krye të ushtrisë partizane dhunoj në Shqipëri në qindra e qindra raste konventat nëndëkombëtare të Gjenevës, Hagës, për mbrojtjen e popullatës civile, robëtarë të luftës, të sëmurëve dhe të plagosurve të luftës, etj., etj.

"E vërteta të detyron", thotë një folle latine, prandaj sot është në interes të çdo shqiptari, të raportit të tij me të vërtetën historike të kombit të vet të shtrëngë pyetje: A u çliruan vërtet me shqiptarët, më datë 28 nëntor 1944?

Në përpjekjen për një përgjigje objektive të kësaj pyetje do të gjejmë se e vërteta e çlirimit tonë, është një medalje me dy faqe. Në njërin anë, është e vërtetë se, në raport me pushtimin gjerman, ne u çliruan pasi gjermanët, në humbje e sipër të luftës, u tërhoqën nga Shqipëria në nëntor të vitit 1944 dhe në shqiptarët dolën nga Lufta e Dytë Botërore të rënditit në anën e aleatëve. Po

me 28 nëntor të vitit 1944, Enver Hoxha u instalua në Tiranë me qeverinë e tij dhe mbajti fjalimin e gjatë të fitores. Gjatë kësaj lufte, flijuan jetën dhe rininë e tyre, mijëra djem dhe vajza, burra e gra të kombit tonë dhe, dhjetëra e mijëra të tjerë luftuan me guxim, vendosmëri pushtuesit nazifashistë dhe renditën kështu Shqipërinë, në anën e drejtë të historisë. Nderimi për ata që flijuan jetën për ideale të lirisë do mbetet i përjetshëm. Gjaku dhe sakrificat e tyre qëndron në themele të lirisë tonë kombëtare. Sikundër i tillë do mbetet nderimi edhe për të gjithë ata që luftuan kundër pushtuesve për lirinë kombëtare dhe nuk u sollën gjatë luftës si kainë ndaj vëllezërve të tyre, nuk kryen akte terroriste, gjenocide dhe krime kundër njerëzimit. Ndërsa të gjithë autorët e akteve të tilla, për krimet e tyre monstruozë, kanë përfunduar dhe do të përfundojnë aty ku dhe kanë vendin, në koshin e plehrave të historisë. Me këtë rast dua të shtoj këtu se, këto të vërteta historike nuk mund të mohohen, pavarësisht nga manipulimet dhe falsifikimet monstruoz të luftës nga historianët hoxhistë, si rritja me disa herë i numrit të të rënëve, shpikja e betejave edhe të paqena, stërvyrja e humbjeve të shakatuara armikut etj. etj. Këto të vërteta për luftën partizane, nuk mund të mohohen as nga gjenocidit dhe krimet kundër njerëzimit që udhëheqja komuniste shqiptaro-slave kreu gjatë luftës, madje nuk mund të mohohen as dhe nga karakteri vëllavrasës dhe civil që dominoi këtë luftë, pasi Enver Hoxha dhe klika e tij, për qëllime të pushtetit personal dhe i urdhëruar nga padronët e tij serb, i dhanë me qëllim asaj pas shkelimitit nga ai të Marrëveshjes historike të Mukjes, në shtator të vitit 1943.

Këto të vërteta nuk mund të mohohen as dhe nga disa veçori të pamohueshme të pushtimit gjerman në Shqipëri apo mungesa e betejave frontale



kundër tyre. Ata nuk mund të mohohen as dhe nga fakti se ushtritë gjermane u tërhoqën vetë për qëllimet e tyre gjeo-strategjike, jo vetëm nga Shqipëria, por edhe zona të tjera të rajonit. Në idenë e saj, lufta kundër pushtuesve, ishte një luftë e drejtë. Aleatët anglo-amerikanë kishin njohur, vlerësuar, mbështetur, financuar dhe furnizuar me armë, uniforma, ushqime, para, specialistë, ushtritë partizane. Qeveritë e vendeve aleate kishin mirëpritur dhe përsënditur në fillim luftën e shqiptarëve kundër pushtuesve. Në mënyrë të pamohueshme forcat partizane komuniste ishin dhe njësitë më të organizuara dhe më numerike në teatrin e luftës në Shqipëri. Por duhet thënë se kjo jo për shkak të mbështetjes së tyre të gjerë në popull, por, para së gjithash, për shkak të dobësisë të pamohueshme dhe qëndrimeve kaotike të nacionalistëve shqiptarë. Është i drejtë dhe plotësisht i justifikuar, dhe menjaj me i detyrueshëm, dënimi me ashpërsi i të gjitha qëndrimeve ç'njerëzore antikomuniste të klikës serbo-shqiptare që udhëhojë luftën. Por është tejet i gabuar mohimi i luftës, i gjakut të derdhur dhe sakrificave të mëdha që partizanët pavarësisht nga orientimi i tyre politik bëjnë për liri.

Nuk duhet të harrojmë asnjëherë se renditja në anën e drejtë të Luftës së Dytë Botërore pati një rëndësi të veçantë për Shqipërinë. Kjo, jo vetëm për dinjitetin kombëtar të shqiptarëve, por edhe për faktin se, me gjithë mbështetjen që aleatët i kishin dhënë luftës së popullit shqiptar kundër pushtuesve, ata, që në krye të herës kishin lënë të hapur, dhe këtu me sa duket nën diktimin e Greqisë, çështjen e përcaktimit të kufijve të Shqipërisë. Pasi tyre, kufijtë e Shqipërisë të të caktoheshin pas luftës, në Konferencën e Paqes. Këtu qëndron me shumë se në çdo drejtim tjetër dhe rëndësia e pamohueshme e renditjes së Shqipërisë në anën e aleatëve, pasi renditja në anën e kundërt, gjë për të cilën kishte edhe shqiptarë që punonin, mund të shoqërohej me ndëshkime të rënda, si palë e humbur.

Por ana tjetër, ana e zezë e medaljes së datës së 28 nëntorit 1944, pra datës së Çlirimit, është se kjo datë, jo që nuk do të shënonte çlirimin e vërtetë të shqiptarëve dhe Shqipërisë, por vetëm do të sillte zëvendësimin e pushtimit gjerman me specifikat e tij me pushtimin serb, Jugosllav shumë herë më të rrezikshëm për vet ekzistencën e kombit shqiptar, siç në vendosjen e diktaturës 46-vjeçare më të egër, më moniste, si pushtimi i brendshëm më barbar, që shqiptarët kishin njohur në tërë historinë e tyre. Kështu që, kjo datë e nëntorit të vitit 1944, është edhe dita e vendosjes së një pushtimi më të zi për shqiptarët. Këtu me poshtë do të ndalem shkurtimisht në vendosjen e pushtimit serb, Jugosllav, pas 28 nëntorit të vitit 1944, në Shqipëri.

Ky zëvendësim i pushtimeve ndodhi, sepse në Tiranë, në pushtet do të vinte partia dhe ushtria e themeluar, e drejtuar dhe e udhëhoqur nga serbët e PKJ dhe Tito, dhe vegla e tyre Enver Hoxha, të cilët pasi shitën Kosovën, kishin vendosur dhe punonin së bashku me Beogradin për projektin oguzri e antiko-

mbëtar, aneksimin e Shqipërisë si Republikë e 7-të e Jugosllavisë.

At Zef Pellumbi, dëshmitar i çlirimit të Shkodrës, shkruan në kryeveprën e tij "Rrno vetëm me tregue" se: me datën 29 nëntor Shkodra u gdhni e mbushur me flamuj Jugosllavë dhe se në kamberin e Katedrales së gytetit, flamuri shqiptar pa yll u zëvendësua nga një partizan me flamurin Jugosllav. Pra, në qytetin e përjetshëm të shqiptarëve, si dëshmi tragjike e zëvendësimit të pushtimeve, flamuri i pushtuesit që iku u zëvendësua jo me flamurin kombëtar, por me flamurin e pushtuesit të ri. Kështu mjerisht, më 28 nëntor të vitit 1994, shqiptarët festuan çlirimin, lirinë, të mashtuar si kurrë më parë në historinë e tyre dhe, duke mos e kuptuar shumë prej tyre se, pikërisht këtë datë, ata hynë në një pushtim të ri. Më saktë ata bhororitën atë ditë një klikë shqiptaro-Jugosllave me në krye Enver Hoxhën, që u instalua në pushtet me projektin makabër të asgjësimit të lirisë së tyre kombëtare, pavarësisht së Shqipërisë dhe aneksimin e saj si Republikë e 7-të në Federatën e Sllavëve të Jugut, armiqve shekullorë të kombit shqiptar.

Pas kësaj dite pra, 28 nëntorit 1944, instalimit në Tiranë të klikës shqiptaro-serbe të Enver Hoxhës, vendosjes nga ky i fundit i veriut të Shqipërisë dhe më pas edhe Kosovës nga Tito në pushtim dhe administrim ushtarak, gjenocidit dhe krimet kundër njerëzimit në Shqipëri dhe në Kosovë, do të merrnin dhjetëra e mijëra jetë të pafajshme, ose do të largonin nga vendi mbi qindra, mijëra shqiptarë. Me këtë dhunë dhe terror të egër ndaj shqiptarëve, Tito me vasalin e tij Enver Hoxha, me ushtritë të tyre partizane do të vazhdonin të ecnin me vendosmëri në zbatimin e doktrinës së Çubrilloviçit në Kosovë, por në një farë varanti të saj edhe në veriun e Shqipërisë. Ata do të zhduknin çdo pengesë në rrugën e aneksimit të plotë të Kosovës si krahinë e Republikës së Serbisë, si dhe për asgjësimin e pavarësisht dhe bashkimin e Shqipërisë me Federatën e Sllavëve të Jugut, si Republikë e shtatë e saj. Aneksimi i Shqipërisë nga Federata Jugosllave, ishte akti i fundit i tragjedisë së madhe që Josif Broz Tito, PKSH dhe Enver Hoxha, po realizonte ndaj shqiptarëve. Ky akt, vinte si kurorëzim i instalimit të kalit të Trojes në Tiranë, injorimit total gjatë luftës nga Enver Hoxha, të çështjes së Kosovës dhe vësiet të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, vendosjes së tyre në vartësi të PKJ dhe mbështetjes së plotë të pushtimit serb të tyre. Aneksimi i Shqipërisë si Republikë e 7-të e ish-Jugosllavisë, ishte një projekt i Titos dhe udhëheqjes Jugosllave, që në vitet e luftës. Me përfshirjen e Shqipërisë si Republikë e 7-të e Federatës Jugosllave, përveç ëndrës së vjetër të Serbisë, daljes së saj në Durrës, sipas tyre do të merrte një zgjidhje përfundimtare edhe problemi i shqiptarëve të Kosovës në kuadrin Federatës së Jugosllavisë. Madje, duket se për këtë projekt, ata kishin bindur edhe vetë Stalinin, i cili në takimin me Titon dhe delegacionin e tij në Moskë, i kishte porositur që të "glabëronin Shqipërinë". Në të vërtetë, në dokumentin e AVNOJ-it, në nëntor 1943, udhëheqja komuniste Jugosllave, nuk ftoi fare përfaqësuesit e Kosovës dhe në kundërshtim me atë çka kishte premtuar, Kosovën e la si krahinë të Serbisë. Në këtë konferencë, Tito shpalli në tërësi Republikën Federative të Jugosllavisë dhe njësitë apo republikat e saj. Ai, në këtë dokument, kishte lënë të hapur mundësinë e pranimit të federatë të republikave të tjera, natyrisht pa cituar nominalisht Shqipërinë, por duke vetëkuptuar, para së gjithash atë.

Kështu që, pas datës 28 nëntor 1944, jo rastësisht, por në funksion të zbatimit të projektit të aneksimit të Shqipërisë nga federata e Titos, në zyrat e pushtetit të ri në Tiranë, në të gjitha nivelet e tij në parti, qeveri, ushtri, polici, sigurim, arsim, tregti, ndërtim, miniera, etj., do të vërshonin këshilltarët Jugosllavë, vendimarrësit e vërtetë të vendit. Jugosllavizimi me shpejtësi dhe në çdo qelizë të shtetit dhe shoqërisë shqiptare, ishte misioni i tyre më kryesor. Madje, autoritetet Jugosllave me lejen e Hoxhës, do të instalonin në Shkodër, legalisht një seksion të shërbimit OZNA (shërbimit të fshehtë Jugosllav, para ardhjes së UDB) që vepronte e ushtronte terror njëjloj si në Kosovë, i pavarur dhe me autoritet të plotë kundër qytetarëve shqiptarë më mbarë veriun e vendit. Ky seksion i OZNA-s, në mënyrë të pavarur nga autoritetet shqiptare, ndalonte, arrestonte, rrëmbente për në ish-Jugosllavi, madje edhe pushtakton brenda territorit të Shqipërisë, qindra dhe qindra shqiptarë, të cilët i konsideronin antijugosllavë.

Në bashkëpunim të ngushtë me këshilltarët e Titos dhe me zell dhe entuziazëm të veçantë, udhëheqja komuniste e Shqipërisë, do të përfundonte dhe do të firmoste me shpejtësi të rrafshme, që në muajin dhjetor të vitit 1944, Traktatin e Bashkëpunimit dhe Ndihmës së dyanshme midis Tiranës dhe Beogradit, si kuadër ligjor i paradhomës së bashkimit midis dy vendeve. Traktatin e firmosi vetë Marshalli Tito.

Të dy qeveritë, po në procesin e bashkimit të plotë të të dy vendeve, firmosën një seri marrëveshesh të tjera për bashkimin ekonomik, doganor, monetar. Krejt ndryshe nga sa paraqitet në këto dokumente hoxhistë, Enver Hoxha, firmosi dhe pranoi që të dislokoheshin në Shqipëri divizione të ushtrisë Jugosllave. Ai pas kësaj, i propozoi Titos, bashkimin e ushtrive me një Komandë dhe Shtatmadhori të përbashkët, pra unifikimin e komandës ushtarake të të dy ushtrive. Në sistemin arsimor të vendit, në të gjitha nivelet, serbishtja do të bëhej gjuha e detyruar. Të gjitha shkollat, klasat, sallat dhe oborret e tyre, buçisnin nga këngët dhe bhororitjet për Marshallin Tito, për bashkim-vllazërimin me popujt e Jugosllavisë. Letrat, artit, muzika, folklori, prodhimet e tjera artistike Jugosllave, do të mbushnin hoshkëllan e krijuar me ndalimin e veprave letrare artistike të shkrimtarëve dhe artistëve shqiptarë, që nuk kishin mbështetur apo kishin kundërshtuar vendosjen e regjimit komunist në Shqipëri. Enver Hoxha do të mbante fjalime në Kuç e gjetiu kundër Fishtës. Ai, në këto fjalime do të krahasonte gjenitë e epikës së letrave tona me Vladan Gerojeviçin, ish-kryeministrin serb në vitin 1913, që kishte kryer masakrat më të mëdha ndaj shqiptarëve dhe ishte shprehur se "shqiptarët, janë njerëz primitivë". Independentistët, ata që shpreheshin për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë shpallëshin si revanshiste. Për klikën e Tiranës dielli tashmë lindte nga Beogradit! Ekonomia shqiptare u vendos e tëra në duart dhe kontrollin e dhjetëra e dhjetëra ndër-marrëzve Jugosllave, që u krijuan me shpejtësi në Shqipëri. Në kontekstin e aneksimit të Shqipërisë, asgjësimit të pavarësisë së saj, në mbledhjen e Byrosë Politike, të dt. 8 janar 1945, Enver Hoxha si promotor kryesor i bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, propozoi "bashkimin e PKSH me PKJ, mbi baza federative, me Sekretar

Opinion i Ditës

Zoje Jakaj (Xhoi) *

(Vijon nga faqja e parë)

... nga afër dramën që mbart sistemi në vite e për të cilën nuk po aludoj se mban përgjegjësi individuale, pasi kushtet e rënda të banimit, strehimit, lagështirës dhe infrastrukturës tejet të amortizuara në burje ka vite që lëngojnë e nuk njohin përmirësim. Aty ka minoronë, të rinj, të moshuar, një numër i madh të sëmurës kronike dhe me sëmundje të rënda, përpos numër shumë i lartë të dënuarish në dhoma e në pamundësi totale nga stafi i punonjësve në burje për t'i rregulluar në bazë të moshës, për shkak të infrastrukturës së dobët që paraqitet në rreth 70% e burjeve në Shqipëri. Me të njëjtin ligj trajtohet një prodhues i lëndëve narkotike, një përdorues dhe nuk përjashtohen në më të shumtën e rasteve nga zbatueshmëria e ligjeve të ashpra as personat me sasi të vogla droge të kapura në trafikim apo përdorim.

Po çfarë është amnistia për ata që nuk e njohin këtë term, amnistia është një fjalë që rrjedh nga greqishtja (ἀμνηστία, amnestia) e që në shqip nënkupton harresën, fshirjen nga kujtesa. "Fshirja e krim-it" nga kujtesa e institucioneve ligjzbatuese, është e mundur në fakt, kjo konsiston në heqjen dorë nga ana e shtetit të ndjekjes penale të disa krimeve/kundërvajtjeve të caktuara. Në këtë rast bëhet fjalë për një parashikim të përgjithshëm faljeje, që në gjeenezë e saj është frymëzuar nga arsye oportuniteti politik dhe pajtimi social, ndërsa në ditët e sotme amnistia konsiderohet edhe si një instrument për të zgjidhur "mbipopullimin e burjeve".

Për këtë arsye sugjerohet që "fshirja e kujtesës" për krime të caktuara të ndodhë edhe në Shqipëri, duke pasur parasysh situatën dhe gjendjen e institucioneve të vuajtes së dënimit dhe paraburgimit, e mbi të gjitha, kategori të caktuara të dënuarish e paraburgosurish siç janë gratë, vajzat, të miturit dhe të sëmurët terminalë. Duke sjellë në vëmendje ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale të hyra në fuqi më datë 01.08.2017, e konkretisht shfuqizimin e nenit që parashikonte lirim para kohe për arsye shëndetësore, tashmë është qeveria dhe Kuvendi që nëpërmjet ligjit për amnistinë duhet t'i japin zgjidhje kësaj problematike që më parë është zgjidhur nga gjykatat.

Përveç shqiptarëve penale të caktimit dhe masës së dënimit që zbatohet gjykatat, krahas me to dhe pa rëndësi në kundërshtim me njëra-tjetrën, qeveria

Amnistia e munguar dhe të drejtat e njeriut



dhe Kuvendi kanë të drejtën të zbatojnë politikën e tyre nëpërmjet ligjit për amnistinë. Kjo në tërësi është edhe një rregullator perfekt, nëse ka shkelje të të drejtave të dënuarve nga gjykatat apo vendimet e tyre të padrejta për veprat e lehta penale dhe shtresat vulnerable e në pamundësi ekonomike. Por, kurrsesi nuk duhet të nënkuptojë që meqenëse qeveria e Kuvendi e kanë këtë të drejtë kushtetuese të vendosin sipas oportunitetit politik apo privilegjit për kategori të caktuara dhe kjo të përdoret politikisht (si psh., rasti i amnistisë nga ndjekja penale të politikantëve në Rumani, që ngjalli protesta popullore).

Në mënyrë që ligji për amnistinë të japë efektet dhe të përmbushë qëllimin e tij humanitar është e nevojshme kryerja e një studimi të mirëfilltë paraprak nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, përpara se të dillet në përfundim nëse do të ketë apo jo ligj për amnistinë. Deklaratat e nxituara mbi një ligj për amnistinë, pa pasur një studim paraprak në tërësi mbi situatën e të burgosurve, paraburgosurve, personave nën hetim, të dyshuarve për vepra penale të caktuara, situatën e burjeve, mbipopullimit dhe të kriminalitetit në vend, të veprave penale relativisht të lehta për të cilat parashikohen dënime të rënda, etj.

Pra, nuk i shërbejnë qëllimit human të ligjit dhe unë si një ish-drejtorë burgu nuk do e sugjeroja kurrë një amnistie në kundërshtim me ligjet në fuqi.

Më poshtë po sjell në vëmendje për-caktimet ligjore për dhënien e amnistisë.

-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 81 parashikon të drejtën e Këshillit të Ministrave, çdo deputeti, si dhe 20 mijë zgjedhësve për të propozuar ligje.

Ligji për amnistinë miratohet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, duke u vendosur në një nivel me ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta, ligjin për shtetësinë, ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore, ligjin për referendume, kodet, ligjin për gjendjen e jashtëzakonshme, ligjin për statusin e funksionarëve publikë dhe ligjin për ndarjen administrative të republikës.

- Nga ana tjetër, në nenin 151 të Kushtetutës parashikohet se çështjet që lidhen me tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë, me kufizimin e lirisë dhe të drejtave themelore të njeriut, me buxhetin, taksat e detyrimet financiare të shtetit, me vendosjen dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme, me deklarimin e luftës dhe të paqes dhe me amnistinë nuk mund të shtrihen në asnjë referendum.

-Referuar këtyre parashikimeve kushtetuese si dhe rëndësisë që Kushtetuta i jep ligjit për amnistinë, nuk mund të shtrohet për t'u votuar me referendum, duke marrë parasysh ndeshmërinë që kanë të dënuarit, të paraburgosurit, personat nën

hetim apo të dyshuarit për një veprë penale dhe të afërmit e tyre, ata kanë të drejtë të kërkojnë amnistie, por Kushtetuta ia ka dhënë të drejtën për ta votuar ligjin për amnistinë vetëm Kuvendit me një shumicë të caktuar siç është tre të pestat dhe jo popullit me referendum, pas propozimit të Këshillit të Ministrave, çdo deputeti si dhe 20 mijë zgjedhësve.

Në këtë aspekt, si nga ana e propozuesve të ligjit, ashtu edhe nga ana e miratuesve të tij, duhet patur parasysh qëllimi i ligjit për amnistinë dhe fryma e tij. Qëllimi i ligjit për amnistinë mund të përshkruhet si krijim i një infrastrukture ligjore, e cila synon krijimin e një ambienti të qëndrueshëm në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit, e udhëhequr nga parimet e humanizimit, rrezikshmërisë së ulët të personave, të cilët amnistohen si dhe mbrojtjen e interesave publike.

Miratimi i këtij ligji duhet të synojë të ketë si efekt pozitiv realizimin e qëllimit të dënimit, po ashtu të ndikojë pozitivisht edhe në risocializimin dhe riintegrimin e personave të dënuar për kategori të caktuara të veprave të lehta penale.

Ndaj, si një ish-drejtorë burgu grash që kam parë shumë vajza e gra vulnerable dhe të pamundura nga ana financiare të paguajnë avokat, por ndiqen me avokat kryesisht të caktuar nga shteti, sepse në shumë raste janë të braktitura nga familjet e sugjeror vit për vit amnistinë për vepra penale të lehta, pasi dënimi në Kodin Penal është shumë i lartë të gratë, të sëmurët terminalë, të miturit, etj. Personalisht mendoj se amnistia e përgjithshme, pra për të gjithë të dënuarit është e gabuar dhe shpesh përdoret nga politika, në kundërshtim me politikën penale që ndjekin gjykatat në vend. Nga amnistia e fundit që hyri në fuqi në janar të këtij viti kanë përfituar edhe disa të dënuar edhe për vepra të rënda. Kjo nuk duhet të ndodhë më, pasi nuk është ky qëllimi i amnistisë e ndaj duhet studim i hollësishtë me ekip të specializuar të jurisprondencës dhe jo vetëm. Të dënuarit përfitojnë çdo vit ulje dënimi me 3 muaj nga gjykatë e kjo nuk është pak, doja ta sqaroj edhe këtë detaj për që ata që nuk punojnë në sistemin e burjeve dhe nuk i kuptojnë si klawzolë të ligjit. Gjithsesi, jam e mendimisht se amnistia duhet të zbatohet, pasi përveçse ul mbipopullimin, ka një efekt shumë social në shoqëri, nëse amnistia trajtohet në këtë formë dhe nuk përdoret politikisht.

***Doktoreshë shkencash**

Ish-drejtorë burgu

← të përgjithshëm për PKSH Marshalin Titon, si kusht i domosdoshëm i bashkimit të Shqipërisë me Federatën Jugosllave. Vendosmërinë e tij për zhdukjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe bashkimin e saj si Republikë e 7-të me Federatën Jugosllave, Enver Hoxha, do ta dëshmonte edhe nëpërmjet një letrë të drejtuar Josif Broz Titos. Lidhur me bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Në këtë letër, ndër të tjera, Enver Hoxha shkruan: "Nga shoku Savo, na është sygjyerur... një hap tjetër përpara në lidhje me formimin e shteteve tona, d.m.th., në rast se shkohet sa më shpejt në bashkimin e dy popujve tanë", dhe se vazhdon ai: "Ky bashkim, s'ka asgjë formale, por ndihet thellë në zemrat e popullit tonë. Ne, duhet të punojmë konkretisht për Federatën dhe për këtë gjë, në vendin tonë punohet me të gjitha format".

Më poshtë, Hoxha vazhdon: "Ne kemi nevojë të na thuhet nga ju, nëse ka ardhur momenti kur neve duhet të marrim në shqyrtim çështjen e bashkimit dhe të mbrëmërinë në konkluzione", dhe së fundi "Ne kemi bindjen se, sikundër Komiteti Central i Jugosllavisë do të na sqarojë dhe do të na këshillojë hapat dhe shoqërisht mbi këtë çështje të rëndësishme për të dy vendet tona". Po

në këtë linjë është edhe deklarata e Titos dhënë agjencisë AP, në vitin 1946, se, "Kosova dhe territoret e tjera shqiptare do t'i aneksohen Shqipërisë". Kjo deklaratë, është bërë vetëm e vetëm me projektin e "glabërimit të Shqipërisë etnike" pra, Shqipërisë, Kosovës dhe territoreve të tjera shqiptare, si dhe shndërrimin e tyre në Republikën e 7-të të Jugosllavisë. Ky projekt organizoi, në të cilin ora e kombit shqiptar kishte ndaluar edhe ecte me orën e Beogradit, po shkente i sigurt dhe pandalshëm drejt realizimit të tij. Kështu që Shqipëria, de facto e pushtuar nga jugosllavët nuk u shndërrua dot sipas projektit Tito - Enver në Republikë të 7-të të Jugosllavisë, por kjo nuk ndryshon faktin se 28 nëntori 1944, dita që Enver Hoxha dhe qeveria e tij hyri triumfalisht në Tiranë është, gjithashtu, edhe dita e triumfit të serbëve, armiqve tanë shekullore mbi të gjithë shqiptarët. Në shekujt shqiptarë dhe serbët ishin përballur me dhjetëra e dhjetëra vjetër. Nga mesi i viteve 1800 e këtej, serbët i kishin fituar në tërësi të gjitha luftërat kundër shqiptarëve, kishin dalë në Durrës dhe pushtuar shumicën e territoreve tona, kishin kryer gjendje dhe masakrat më të tmerrshme ndaj nesh. Kishin arritur të bindin zotërit e kësaj toke se nuk ekzistonte

komb shqiptar Por, në të gjitha këto luftëra, serbët kishin pasur ndihmën politike, ushtarake, financiare të perandorive më të mëdha të kohës, përveç Austro-Hungarisë. Kurse fitoret e tyre më të madhe që nga koha e Car Dushanit ndaj kombit shqiptar, fitoren e 28 nëntorit të vitit 1944, serbët e arritën jo me mbështetjen dhe ndërhjryjen direkte në anën e tyre të fuqive të mëdha, por e realizuan nëpërmjet shqiptarëve, kalit të Trojes, lëvizjes jugosllave që themeluan dhe udhëhoqën në Shqipëri dhe Kosovë, me Enver Hoxhën dhe veglat e tyre në Shqipëri, Fadil Hoxhën dhe vasalët e tjerë shqiptarë në Kosovë.

Me gjithë këto, e majta shqiptare e kryesuar nga Edi Rama mban ndaj kësaj dite qëndrim të njëjtit identik me atë të diktatorit stalinist, Enver Hoxha.

Edi Rama, pinjoll i bllokmenëve hoxhistë, 27 vite me parë thërriste dhe shkruante "Të sulmujmë bllokun", "Të nxjerrim jashtë ligjit PPSH".

Sipas tij, "Lufta kundër okupatorit degjeneroi në një luftë të përgjithshme civile", "shkaktoare e të cilës ishte PKSH, e drejtuar nga emisarë jugosllavë" dhe se kjo ndodhi, "për shkak të luftës për pushtet të general Enver Hoxha" dhe se "Partia Socialiste që ka dalë

nga mitra e përgjakur e krim të PPSH duhet të dalë jashtë ligji ose të rithemelohej". Apo se "Kongresi i Përmetit ishte legjitimimi i diktaturës". Madje dhe se, "Për sa kohë PS nuk ka bërë denoncimin e plotë të origjinës dhe historisë së saj, ajo nuk mund të ketë të drejtën për të qenë një parti e ligjshme". Asokohe Edi Rama nuk kursente as të rënë për liri, ai shkruante se "Gjaku i dëshmorëve është gjaku i rremë në themel të kolltukëve".

Në këtë shkrim i ndala shkurtimisht vetëm në njërin aspekt tragjik që mbarte në vete ajo që e majta shqiptare e feston si ditë çlirimi dhe që e kremton jo për të nderuar të rënë e luftës as dhe luftëtarët idealistë të saj, por për të mbrojtur terroristët, xhelatët, klikën serbo-shqiptare të Enver Hoxhës që u instalua në Tiranë më datën 28 nëntor të vitit 1944. Sikundër shtoj se nuk u ndala këtu në aspektin më katastrofal të kësaj date, si ditë e pazotë e vendosjes së diktaturës moniste me miraz të të gjitha kohërave në Shqipëri, diktaturës hoxhiste.

Duke përfunduar ftoj çdo shqiptar, që në ditën e të vërtetave të pakundërshtueshme të historisë dhe për hir të raportit me të vërtetën që duhet të ketë njeriu i qytetaruar të reflektojë rreth saj! Më mirë vonë se kurrë!

HOROSKOPI

DASHI

Përpunimi të mos keni besim të pakufishëm në burimet tuaja dhe përpunimi të jeni me objektivi, nëse nuk doni që të përballet me zhgënjime. Kujdesuni për shëndetin. Bëni veprimtari fizike dhe shëtitje në natyrë, edhe pse është një stinë e ftohtë.

DEMI

Keni arsyet më të mira për të ndihmuar një familjar që të tejkalojë vështirësitë dhe pasiguritë. Në këmbim do të merrni shumë mirënjohje të sinqertë. Me Mërkurin në shenjë, do ta keni rrugën e hapur për të pasur veprimtari kulturore.

BINJAKET

Nën mbikëqyrjen e Plutonit, Hëna do të vërë në pah anën më kokëfortë të karakterit të juaj. Mbase mund të rikthehen zëna të vjetra familjare, Marsi është kundër: nxitimi mund të bëjë që të bëni gabime. Prandaj përpara se të veproni, mendojeni mirë atë që do të bëni!

GAFORJA

Për meritë të pozicionimit të Saturnit, në lidhje me Hënë, do të përballeti me shpirtin e përshatjes një ndryshim të papritur programi. Me një shtytje të mirë do të jetësoni projektet e juaja, duke tejkaluar pengesat.

LUANI

Në familje do të keni disa kundërshtime të shkaktuara nga këndvështrimet e ndryshme. Mos u merrni! Larmishmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për tu rritur. Falënderoni koleqet që ju rrinë pranë duke ju dhënë ide dhe mundësi të mira.

VIRGJERESHA

Sot yjet nuk janë shumë të shkëlqyeshme. Do të shqetësoheni për çështje profesionale, të cilat do të dalin se nuk janë problematike! Në punë mos bëni shumë në sy, rritni të qetë dhe shtafiqi aftësitë e juaja në momentin e duhur.

PESHORJA

Për faj të Neptunit kundër, nuk është rasti për të bërë beteja kundër mullinjve të ertës. Prandaj mos e çoni ndër mend se mund të ndryshoni botën! Si zakonisht, mbi të gjitha për çështje pune, reagoni duke u mbështetur mbi vendosmërinë dhe saktësinë.

AKRËPI

Me Venusin, Marsin dhe Jupiterin bashkëpunorë, perspektivat sentimentale janë të mira. Mund të nisni një histori pasioni, e cila mund të kthehet në një lidhje të qëndrueshme. Ndoshta në dashuri nuk jeni ende gat për të ndërmarrë hapin madhor, por me siguri drejt asaj rrugë jeni.

SHIGJETARI

Keni nevojë të kaloni çaste të qeta. Largoni me takt persona që nuk janë shumë pozitiv, të cilët ju marrin nëpër këmbë, dhe buzeqeshini jetës. Hëna bën që të provoni të zgjidhni një problem midis miqve, por nuk do ta keni të thjeshtë.

BRICJAPI

Me Venusin dhe Marsin ogurmirë, dashuria do të vazhdojë të ketë një rol shumë të rëndësishëm në jetën dhe mendimet e juaja. Do të përjetoni edhe anë e ëmbla. Në vizitë e juaja, edhe pse e shkurtër, do të gëzojnë një familjar apo një të afërm. Do të ndiheni të kënaqur.

UJORI

Jeni përballë një zgjedhjeje të rëndësishme, qëndroni zgjedhjeve të bëra më parë dhe mos hiqni dorë nga autonomia e juaj. Mos i lejoni një familjari t'u pengojë. Do t'ia dilni të angazhoni në nismat e juaja, duke prekur pikat e duhura emocionale.

PESHQIT

Hëna shqetëson Uranin në qiellin tuaj dhe atmosferën që jetoni me atë që ju ka hyrë në zemër. Pakënaqësia prirë të mbi-zotërojë. Mos e vini në dyshim atë që ndëroni për partnerin që në zënat e para që keni me të.

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 6 Dhjetor 2017

GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Vajza rome me këmbën e fashuar i buzëqesh kryeministrit
- Berisha përshëndet Ramën me foton e qytetarit dixhital
- I biri ka ditëlindjen, deputeti urim special për Ersin...
- Donald Lu siç nuk e keni parë, veshja e re e ambasadorit

E konfirmoi edhe Vin Veli, tashmë çifti s'është bashkë



Kejvina Kthella ndryshon 'look'. Kështu s'e kemi parë asnjëherë



Egla Harxhi:



Lidhja jonë treshe s'ka qenë 'show', por një 'provokim' për shoqërinë shqiptare

"Në jetën tonë do të vijë një fëmijë. S'do e çoj në shkollë, larg mendimeve mediokre të shqiptarëve"

Intervista

Rrëfëhet modelja 26-vjeçare: Ja cili është xheloz në lidhjen tonë treshe

Egla Harxhi:

Lidhja jonë treshe s'ka qenë 'show', por një 'provokim' për shoqërinë shqiptare

"Në jetën tonë do të vijë një fëmijë. S' do e çoj në shkollë, larg mendimeve mediokre të shqiptarëve"

Pamela Aliaj

Ajo është vendosur në qendër të vëmendjes si femra e parë në Shqipëri e cila u njoh për lidhjen e saj treshe. Pas këtij lajmi ish-misi nga Vlora, Egla Harxhi, së bashku me dy partnerët e saj ka qenë e ftuar kudo për t'i dhënë një zë këtij lajmi kaq të bujshëm. Në një intervistë ekskluzive për "VIP Pages" të "Gazeta Shqiptare", modelja 26-vjeçare ka folur për jetën e saj, punën me të cilën ajo merret dhe për më tepër pritshmëritë që ajo ka për djalin që do të lindë duke qenë se do të jetë fëmija i 3 prindërve. Ndërkohë që tashmë modelja është shtatzënë me Aleksin dhe jeta e të treve është ndërtuar këtu në Shqipëri duke "braktisur" qytetin e dashurisë, Parisin. Ajo ka zbuluar, gjithashtu, edhe marrëdhënien që të tre kanë me njëri-tjetrin, xhelozitë mes tyre dhe planet për të ardhmen.

Jeni një nga ish-miset bukurose të Shqipërisë. Pse nuk vazhduat modelingun si miset e tjera në vendlindje?

Nuk mund të them se modelingu ka qenë apo është një profesion për mua. Është e vërtetë që jam angazhuar në disa sete fotografish, por gjithmonë ka qenë në një kuadër të eksplorimit artistik dhe shprehjes së emocioneve nëpërmjet fotove. Nuk ka pasur në fokus një drejtim komercial apo në kuadër të një profesioni të mirëfilltë edhe pse ka pasur raste kur kam bërë sete për disa firma. Ar-

syjeja pse u largova nga Shqipëria për një moment nuk kishte të bënte me karrierën në modeling, ishte më tepër nevoja që kisha për të zbuluar diçka ndryshe që fatkeqësisht Shqipëria nuk ta ofron ende. Doja të përjetoja eksperiencën të lidhura me artin, qoftë kjo në fushën e fotografisë, kinemasë apo teatrit. Parisi ishte vendi ideal edhe pse sot nuk është në epokën e vetë më të artit. Kjo zgjedhje erdhi për shkak të natyrës time që kërkon të dijë gjithmonë e më

shumë e të hapë horizonte në fusha të ndryshme.

Jetoni mes Parisit dhe Libofshës. Cila ishte arsyeja që latë qytetin e dashurisë për t'u rikthyer këtu?

Përmes partnerit tim dhe punës time, kam krijuar një rrjet kontaktesh të rëndësishme, të cilat nuk janë domosdoshmërisht të lidhura vetëm me Parisin, por shumë më gjerë. Këto kontakte janë internacionale dhe përfshijnë njerëz në fusha të ndryshme, arti, biznesi apo politika. Kjo do të thotë se për

mua nuk është e rëndësishme të jem në një vend të caktuar gjithë kohën, por mjafton të ngre telefonin kudo që jam për t'i kontaktuar. Aq më tepër sot mund të marrësh avionin dhe të gjendesh kudo nëse është e nevojshme. Jetesa në Paris është një bazë ku kthehem herë pas herë, por sot qëllimi im është të angazhohem në vendin tim. Kur u largova nga Shqipëria ika me një zhgënjim të madh dhe me një dëshirë ndoshta për të mos u kthyer kurrë. E kisha gabim pasi

me gjithë problemet që ky vend ka, ngelet vendi im.

Jeni një nga shqiptaret e para në vend që njiheni për lidhjen tuaj treshe. Çfarë ndryshimi ka nga lidhjet e tjera sipas jush?

Lidhja ime private me partnerët e mi nuk ka qenë asnjëherë qëllim në vetvete për të bërë show dhe nuk dua të shprehem për detajet e marrëdhënies tonë. Ato na takojnë vetëm ne. Për mua ka qenë një mësim mbi sesi funksionon shoqëria jonë dhe këtë e kam parë përmes "provokimeve të mia". Fatkeqësisht jemi një shoqëri që ende nuk e ka kapërcyer pragun e të gjykuarit dhe të mos pranuarit të jetës së tjetrit. Sikur këtë energji dhe zjarr që njerëzit kanë për t'u marrë me jetën e tjetrit ta fokusonin në punë dhe përmirësimin e vendit ndoshta do kishim ecur shumë më përpara. Për mua ngelet një handicap zhvillimi social. Mesazhi i asaj që kam dashur të jap ka qenë shumë i thjeshtë: Secili ka të drejtë ta jetojë jetën e tij si të dojë, për sa kohë nuk cenon jetën e askujt tjetër. Për sa kohë mendimi i të tjerëve nuk është i bazuar në argumente logjike, por i bazuar mbi ligësinë dhe të mos pranuarit të asgjëje për mua nuk ka më vend për diskutim. Megjithatë për të qenë të qartë kjo është një marrëdhënie si gjithë të tjerat e me një sens të fortë përkushtimi ndaj njëri-tjetrit, e mbushur me angazhime dhe përgjegjësi.

A bëheni xhelozë për partnerin tuaj apo edhe për Alesian?

Jemi të lirë dhe askush nuk na ka detyruar që ta jetojmë jetën në këtë formë. Ne kemi një vizion shumë



Egla Harxhi, së bashku me dy partnerët e saj



Është kthyer sërish në qendër të vëmendjes së medias lidhja mes moderatores Bora Zemani dhe Dj. Vin Veli. Sipas të afërmeve të tyre, çifti ka disa muaj që nuk jetojnë më bashkë, ndërkohë që asnjëri nuk është shprehur rreth kësaj çështje. Por në një postim të Vin Velit na lë të kuptojmë se ai e ka pranuar faktin që janë ndarë. Ai ka publikuar në "Instagram" titullin e një shkrimi në të cilin thuhej: "Vin Veli si seks simbol pas ndarjes nga Bora Zemani, miqtë duan të dinë sa ka shkuar lista e pritjes për DJ?". Më poshtë fotos ai ka bërë komentin: "Unë mesa e njoh veten për DJ e njoh," duke mos komentuar pjesën e ndarjes e duke e marrë për të mirëqenë. Mbase kështu Vini po e konfirmon ndarjen?

E konfirmoi edhe Vin Veli, tashmë çifti s'është bashkë

Këngëtarja bukuroshe shtatzënë? Ja çfarë thotë XHENSILA

Kur te japim lajmin e vertet ne te ardhmen, nuk do na besojte me njeri !!!

Megjithse tani jemi mesuar, nje here ne 3 muaj ky lajme del.

Nuk është hera e parë që qarkullon lajmi në media që këngëtarja Xhensila Myrtezaj është në pritje të embël. Kjo ka pikënisjen që me dasmën e çiftit ku shumë aluduan se ata ishin në pritjen e një femije së shpejti. Por kësaj radhe nuk e ka lënë në heshtje një lajm të tillë Xheni. Në postimin e saj të radhës në "Instastory" ajo i ka mohuar këto lajme duke thënë se nuk është shtatzënë dhe se urimet do të duhet të behen kur të jetë i vërtetë ky lajm.



Ajo është velina superseksi e emisionit 'Xing' të Ermal Mamaqit, e cila në çdo postim të bërë surprizon e provokon me pamjen e saj. Ndërkohë që në publikimin e saj më të fundit ajo thuhet se nuk njihet më. Modelja seksi dhe thuhet të bardha dhe të prera mjaft shkurt. Ndryshimi i saj duket mjaft i guximshëm duke i shtuar këtu edhe veshjen provokuese me zhartier. Asnjëherë nuk vjen njësoj dhe gjithnjë paraqitet si një 'bombe' blonde superseksi në fotot e postuara në rrjetet sociale. Një velinë e vërtetë apo jo?

KEJVINA KTHELLA ndryshon 'look'. Kështu s'e kemi parë asnjëherë



të fortë të komunitetit dhe një besim të padiskutueshëm ndaj njëritjetrit, nuk ka vend për xhelozira, apo për vogëlsira pasi qëllimi ynë është shumë më shpirtëror dhe gjithmonë në të mirën e bashkësisë. Mendoj që një lidhje e tillë funksionon vetëm nëse jemi të lirë nga xhelozia, dhe e vetmja mënyrë për ta pasur këtë është të lëmë egon mënjanë.

Kenit mbaruar arkitekturën në Paris dhe jeni muza e partnerit tuaj. Me çfarë pune merret Egla tani? Po Alex dhe Alesia çfarë pune bëjnë për të jetuar?

Secili nga ne ka detyrat e tij dhe ndihmojmë njëri-tjetrin çdo ditë për t'u përmirësuar dhe avancuar përpara. Sigurisht kjo vlen më shumë për ne të dyja pasi Aleksandri ndoshta për publikun njihet si artist, por më duhet të sqaroj që profili i tij është shumë më kompleks. Është dikush që është rritur përmes familjes së tij në botën e



financës, bankave, biznesit të natës dhe edukimi i tij ka qenë tejet i ashpër nga ç'mund ta imagjinojmë. Personalisht kam mësuar shumë për sa i përket këtyre fushave të panjohura për mua më parë dhe më ka hapur mendjen në shumë drejtime.

Ku e sheh veten Egla pas 10 vitesh? A e sheh sërish në këtë lidhje treshe?

Nuk mund të them se ku do të jem këtu e 10 vjet më vonë pasi jeta më ka provuar që asnjëherë planet nuk dalin siç i mendojmë dhe, nëse e forcojmë veten të ndjekim plane



të paracaktuara nuk dallojmë mundësi të reja që na dalin përpara. Gjithsesi për diçka jam e sigurt. Që do të jetë gjithmonë një lloj tek unë dhe ky është shpirti i lirë dhe nevojja për të mësuar.

Ju jeni në muajin e tetë të shtatzënisë. Si mendoni se do të ndihet fëmija juaj nga paragjykimet që kanë njerëzit ndaj një femije me tre prindër?

Aktualisht jam duke ju afruar muajit të fundit të shtatzënisë dhe jam çdo ditë e më shumë e ndërgjegjshme mbi përgatitjen që duhet të kem mbas lindjes. Fëmija jonë do të rritet në një formë të tillë, e cila do ngjasojë me mënyrën se si i ati është rritur. Jam e bindur që djali jonë nuk do të preket aspak nga mendimet e të tjerëve pasi do të edukohet që në fillim me konceptin e të vërtetës, me konceptin e lirisë dhe shprehjes së lirë. Edukimi i tij është prioriteti më i madh që kemi dhe do bëj të pamundurën

